

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020

Departamenti Mbrojtja e Mjedisit

Prishtinë

"Njerëzit janë pjesë e diverzitetit të pasur të natyrës dhe kanë fuqi që ta mbrojnë ose shkatërrojnë atë"

Mesazhi kryesor i Sekretariatit të Konventës së Biodiverzitetit në vitin 2010 për vendimmarrësit botëror

FALËNDERIME

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020 e Republikës së Kosovës është rezultat i punës 16 (gjashtëmbëdhjetë) mujore në projektin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të mbështetur nga Komisioni Evropian përmes TAIEX- it.
Mbikëqyrjen e projektit e ka bërë Komiteti drejtues i kryesuar nga ministri i MMPH - së.
Kjo Strategji është hartuar, bazuar në Raportet e gjendjes së natyrës 2006 – 2007, 2008 - 2009, përgatitur nga AMMK – ja si dhe raportet nga sektorët tjerë me ndikim në biodiverzitet.
Në hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiverzitetin e Republikës së Kosovës 2011 – 2020 kanë kontribuar një numër i madh i ekspertëve nga institucionet qeveritare, shkencore dhe shoqëria civile.
Grupi punues u krijua me Vendimin e Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nr. 03/711/1 i datës 04.03.2009.
Lista e ekspertëve të angazhuar për përpilimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiverzitetin është dhënë në SHTOJCËN I.
Kontributi i të gjithë anëtarëve të këtij grupi gjithëpërfshirës ishte esencial gjatë hartimit të këtij dokumenti strategjik andaj të gjithë anëtarëve të cilët me përkushtimin e tyre kontribuuan, ne ju shprehim mirënjohjen dhe falënderimin më të sinqertë për ketë.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor falënderon gjithashtu Komisionin Evropian që përmes TAIEX (Technical Assistance Information Exchange) me ekspert dhe logjistikë tjetër ka mbështetur këtë projekt.
Në fund një falënderim i veçantë për Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë për ndihmën e dhënë në përkthimin e materialeve nga gjuha shqipe në anglisht dhe anasjelltas.

Prishtinë,

Pozita gjeografike e Kosovës

Kosova bën pjesë në qendër të Gadishullit ballkanik dhe shtrihet ndërmjet paraleles 42° e 44° të hemisferës veriore të Tokës dhe mes meridianit 20° e 22°.
Kosova kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje (351,6 KM), Malin e Zi në veri perëndim (78,6 KM), Shqipërinë në perëndim (111,8 KM) dhe Maqedoninë në jug (158,7 KM), gjatësia e gjithmbarshme e vijës kufitare është 700,7 KM.
Sipërfaqja e përgjithshme:10.908 km²
Popullata: 2,1 milion
Dendësia e popullsisë: rreth 200 për km²
Prodhimi i Përgjithshëm Vendor për banor 1.795 €
Numri i vendbanimeve: rreth 1466
Kryeqytet: Prishtina rreth 400,000 banor
Valuta: EURO
Maja më e lartë: Gjeravica - 2656 mlm.
Lumi më i gjatë: Drini i Bardhë (122 km)
Tokë e punueshme:585.000 ha
Tokë pyjore: 464.800 ha



SHKURTESAT

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
Biodiverziteti	Llojshmëria e organizmave të gjallë që përfshin llojshmërinë brenda llojit dhe ndërmjet llojeve të ndryshme, larminë gjenetike si dhe llojshmërinë e ekosistemeve
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër
DKU	Direktiva Kornizë e Ujërave 2000/60/EC
DMM	Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit
ECNC	European Centre for Nature Conservation/Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës
FSHMN	Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore
GIS	Geographic Information System
HC	Hidrocentral
IHMK	Instituti Hidrometereologjik i Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
KBD - CBD	Konventa e Biodiverzitetit - Traktat Ndërkombetar i nënshkruar në Rio de Janeiro 1992
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MeF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
NATURA 2000	Rrjeti i zonave të rëndësishme ekologjike të Bashkimit Evropian e themeluar me Direktivën e Habitateve (1992) dhe Direktiven e Zogjve (1979)
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OMGJ	Organizma të Modifikuar Gjenetikisht
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PMQP	Projekti i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve
PPV	Prodhimi i Përgjithshëm Vendor
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
SEK	Strategjia e Energjisë për Kosovën 2009 – 2018
SPVB	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin
SKAP - FSC	Standardi i Këshillit për Administrimin e Pyjeve - Forestry Stewardship Council
TAIEX	Instrument i Ndihmës Teknike dhe Këmbim Informacioni që menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e Komisionit Evropian
TKE	Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë
IUCN - UBRN	Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës
UP	Univerziteti i Prishtinës
USAID	Agjencia e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZM	Zonë e Mbrojtur e Natyrës

PËRMBAJTJA

Kapitulli			Faqe
1.		PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
2.		HYRJE	8
	2.1.	Baza ligjore për nxjerrjen e SPVB	8
	2.2.	Kërkesat e Konventës për Biodiverzitetin	8
	2.3.	Integrimet në BE	9
3.		PËRGATITJA E STRATEGJISË	9
4.		ANALIZA E STRATEGJISË	10
	4.1.	Të vazhdohet me informacionet të cilat tashmë janë në dispozicion	10
	4.2.	Afatet kohore	10
	4.3.	Të ndalet humbja e mëtejme e biodiversitetit	10
	4.4.	Zbatimi	11
	4.5.	Ndarja e përgjegjësive	11
	4.6.	Integrimi	11
	4.7.	Gjuha dhe përmbajtja	11
	4.8.	Parimet e Strategjisë	11
5.		VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	12
	5.1.	Vizioni	12
	5.2.	Objektivat strategjike	12
6.		RAPORTET E NËNGRUPEVE	12
	6.1.	Llojet, vendbanimet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonat e mbrojtura	12 - 19
	6.2.	Edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut	20 - 23
	6.3.	Bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkataria dhe turizmi	23 - 32
	6.4.	Ujërat, transporti, minierat dhe energjia	32 - 38
	6.5.	Planifikimi hapësinor dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis	39 - 40
	6.6.	Korniza ligjore dhe institucionale	40 - 45
7.		PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË	46
8.		ZBATIMI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMI	46 - 52
9.		SHTOJCAT	53 - 70

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin është dokument bazë për mbrojtjen e natyrës, i cili i përcakton synimet afatgjata të ruajtjes së biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore, vlerave të mbrojtura të natyrës, si dhe mënyrën e zbatimit në harmoni me zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Republikës së Kosovës. Qëllimi i kësaj strategjie nuk është të listoj të gjitha çështjet e hapura të cilat kanë të bëjnë me biodiverzitetin në Kosovë, por të krijoj një kornizë të synimeve dhe aktiviteteve dhe një koordinim më të mirë, duke i prioritetizuar programet dhe duke ofruar qasje strategjike për zhvillimin e iniciativave në të ardhmen. Veprimet e rekomanduara në këtë Strategji dhe Plan të Veprimit nuk paraqesin "listë dëshirash" për fushën e politikave, legjislacionit, planeve dhe programeve të nevojshme për përmirësimin e gjendjes në sektorët e ndryshëm në vend.

Qëllimi i kësaj strategjie është:

- Ruajtja (konzervimi) i biodiverzitetit;
- Zhvillimi i qëndrueshëm bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore;
- Krijimi i të hyrave; dhe
- Ndarja e përfitimeve nga shfrytëzimi i biodiverzitetit në mënyrë të barabartë.

Përgatitjet për hartimin e këtij dokumenti strategjik kanë filluar në fund të vitit 2008 kur kemi kërkuar ndihmë nga Komisioni Evropian përmes TAIEX – it për ekspertë dhe në fillim të vitit 2009 kur edhe është ngritur Grupi Punues me vendim të Sekretarit të Përhershëm të MMPH - së.
Grupi punues është përberë nga ekspertë vendor të institucioneve dhe lëmive të ndryshme si dhe shoqëria civile. Gjatë gjithë fazave të përgatitjes së dokumentit jemi përpjekur që të sigurohet një proces gjithëpërfshirës duke përfshirë kapacitetet njerëzore të ministrive, ekspertë universitarë, ekspertë të pavarur, zyrtarë mjedisorë dhe përfaqësues të OJQ-ve mjedisore të fokusuara në mbrojtjen e natyrës.
I gjithë procesi i hartimit së kësaj Strategjie ka zgjatur rreth një vit e gjysmë duke pas parasysh se po nxjerrim për herë të parë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiverzitetin dhe mungojnë të dhënat dhe përvoja për të krijuar një dokument i cili do të jetë i prodhuar me "forcat tona" jemi mbështet në përvojën e ekspertëve ndërkombëtar.
Qasja e bërjes së kësaj Strategjie ishte "të mësohet duke vepruar - bërë" (learning by doing), për këtë qëllim u organizuan dhe u mbajtën pesë Punëtori dhe disa takime të GP-ve.
Gjatë gjithë procesit janë bërë përpjekje që Strategjia tu përmbahet udhëzuesve të aprovuar nga Sekretariati i Konventës së Biodiverzitetit lidhur me përmbajtjen e këtij dokumenti si dhe legjislacionit kombëtar.
MMPH - ja ka ushtruar rolin udhëheqës gjatë gjithë këtij procesi por çështjet e ndërlidhura me sektorët me ndikim si: bujqësia, minierat dhe energjetika, turizmi kanë kërkuar harmonizim të veprimeve në mënyrë që kjo Strategji të gjen zbatim dhe të arrihen objektivat strategjike të saj.
Plani i Veprimit ka identifikuar listën e veprimeve dhe projekteve kryesore të cilat do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 (pesë) vjeçare në pesë pilot zonat. Konsiderojmë që zbatimi i projekteve do të ketë nevojë për mbështetje financiare ndërkombëtare prej organizatave donatore.

Rreziqet që mund të përcjellin realizimin e këtij Plani të Veprimit mund të vijnë nga mungesa e mbështetjes financiare për projekte, shumë fusha janë më lartë në prioritet se sa natyra në agjendat e vendimmarrjes, koordinimi i dobët ndërmjet sektorëve si dhe mungesa e fondeve mjedisore.

2. HYRJE

2.1. Baza ligjore për nxjerrjen e SPVB

Baza për nxjerrjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020 në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejmë Strategjia) rrjedh nga neni 140 i Ligjit për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233, i shpallur me dekretin Nr. DL-054-2010, datë 18.10.2010 i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 85 të datës 09.11.2010.

Bazuar në Nenin 141 paragrafi 2 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, Strategjia përmban:

- qëllimet e përgjithshme strategjike;
- synimet për ruajtjen e peizazheve, ekosistemeve, tipave të vendbanimit, llojeve të egra dhe llojeve vendore të zbutura;
- synimet për vlerat e mbrojtura të natyrës;
- synimet për hulumtimet dhe përcjelljen e gjendjes të natyrës;
- synimet për përfshirjen e mbrojtjes së natyrës në sektorët tjerë;
- synimet për kornizën legjislative dhe institucionale;
- synimet për edukim dhe arsimim me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së larmisë biologjike dhe peizazhore;
- synimet për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për natyrën;
- planet e veprimit për zbatimin e synimeve, me theksimin e prioriteteve dhe burimet e mundshme financiare;
- mënyrën e përmbushjes të detyrimeve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës;
- shtojcën hartografike e cila në hapësirë tregon masat e mbrojtjes të larmisë biologjike dhe peizazhore dhe mbrojtjen e vlerave të natyrës.

Strategjinë e nxjerr Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë dhe e aprovon Kuvendi i Republikës së Kosovës.

2.2. Kërkesat e Konventës për Biodiverzitetin (KBD) - Rio de Janeiro 1992

Kosova si shtet i ri ende nuk është palë nënshkruese e ndonjë konvente a marrëveshje në fushën e mbrojtjes së natyrës të cilat do ta detyrojnë për përmbushjen e kërkesave që dalin nga to. Mirëpo në të ardhmën presim që të jetë nënshkruese e Konventës për Biodiverzitetin dhe Startegjia për biodiverzitetin do të jetë një dokument i domosdoshëm. Me këtë Strategji synohet që të përmbushën detyrimet edhe ndaj Konventave tjera si Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (Convention on International Trade in Endangered Species - CITES), Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore të Kulturës dhe të Natyrës (Paris 1972),(World Heritage Convention), Konventa mbi ligatinat (Ramsar Convention) dhe Konventa për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të shtazëve të egra (Convention on Migratory Species - CMS).

2.3. Integrimi në Bashkimin Evropian

Synimi afatmesëm i Kosovës është integrimi në Bashkimin Evropian andaj nevoja e krijimit të një kornize ligjore dhe institucionale adekuate do të jetë përparësi.
Harmonizimi i Ligjit për mbrojtjen e natyrës me Direktivën e Habitateve (1992) dhe Direktivën e Zogjve (1979), Konventën CITES do të jetë një nga synimet strategjike të cilat do të planifikohen edhe me këtë Strategji. Direktiva për zogjtë e egër dhe Direktiva për vendbanimet përbejnë bazën për krijimin e një sistemi reprezentativ të zonave të mbrojtura përmes krijimit të Zonave të Veçanta të Mbrojtjes të natyrës (ZVM) me qëllim të mbrojtjes së një numri të konsiderueshëm të zogjve të egër dhe vendbanimeve në pergjithësi. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka vazhduar edhe nga Direktiva për Habitatet natyrore, që konsiderohet një hap më përpara në ruajtjen e biodiverzitetit për shkak të vendosjes së regjimeve të mbrojtjes ligjore për të gjitha llojet e bimëve dhe shtazëve të rëndësishme për komunitetin Evropian. Kjo Direktivë u soll në vitin 1992 dhe qëllimi i saj ka qenë të krijoj një rrjetë ekologjik Evropian të Zonave të Veçanta të Ruajtjes (ZVR), se bashku me Zonat e Veçanta të Mbrojtjes (ZVM), përbejnë rrjetin ekologjik NATURA 2000 dhe integrojnë kërkesat e mbrojtjes në politikat e sektorëve tjerë si bujqësia, transporti, energjia, turizmi etj.
Synimi i Kosovës për hyrje në Bashkimin Evropian, nënkupton harmonizimin e legjislacionit dhe zbatimin e masave në përputhje me NATURA 2000 përmes krijimit të politikave kombëtare dhe ndërmarrjen e hapave tjerë të duhur, proces ky i cili do të jetë veçanërisht i rëndësishëm përgjatë kohëzgjatjes së kësaj Strategjie por edhe më gjatë.

3. PËRGATITJA E STRATEGJISË

Strategjia (2011 - 2020) është përgatitur përmes një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe aprovimi i saj rastis me Vitin Ndërkombëtar të Biodiversitetit dhe është pjesë e kontributit të Kosovës për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e zvogëlimit të humbjes së biodiversitetit.

Për hartimin e Strategjisë janë krijuar gjashtë Grupe Punuese tematike dhe atë:

- GP Llojet, vendbanimet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonat e mbrojtura;
- GP Edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut;
- GP Bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkataria dhe turizmi;
- GP Ujërat, transporti, minierat dhe energjia;
- GP Planifikimi hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe
- GP Korniza Ligjore dhe Institucionale.

Në punën e grupeve punuese u angazhuan ekspert nga: Institucionet e Qeverisë së Kosovës, Universiteti i Prishtinës, shoqëria civile, të cilët ne hartimin e kësaj Strategjie i shfrytëzuan raportet dhe strategjitë sektoriale. Kyçja gjithëpërfshirëse e ekspertëve të profesioneve të ndryshme, garanton një qasje të integruar për mbrojtjen e natyrës si dhe vendosjen e synimeve të mbrojtjes së larmisë biologjike edhe tek sektorët tjerë.
Në procesin e hartimit janë përfshirë gjashtë grupe, secila prej tyre ishte e përbërë nga tre e më shumë përfaqësues, duke mbuluar të gjitha aktivitetet kryesore të cilat mund të kenë ndikim në biodiversitetin e Kosovës. Janë mbajtur pesë punëtori, gjatë të cilave janë diskutuar dhe pajtuar për vizionin dhe objektivat strategjike, një takim përgatitor dhe dy takime përcjellëse janë mbajtur me kryesuesit e grupeve. Teksti për seksionet e ndryshme

është hartuar nga ana e grupeve, me komente dhe udhëzime nga ekspertët e TAIEX-it të caktuar për të ndihmuar. Procesi i përgatitjes ishte gjithë përfshirës dhe reagues para procesit të konsultimeve publike të cilat do të ndërmerret nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Gjatë tërë procesit të përgatitjes,në mënyrë të pjesshme janë përdorur informatat nga një sërë dokumentesh të publikuara.
Strategjia identifikon veprimet e nevojshme për përmbushjen e objektivave të saj përmes një Plani të Veprimit. Një hap përfundimtar brenda procesit të përgatitjes ishte përgatitja e planeve dhe projekteve për implementimin e veprimeve brenda pesë pilot zonave të zgjedhura të Kosovës. Kjo do të lejojë implementimin në këto pilot zona të cilat do të jenë më pak të kushtueshme dhe aty ku vështirësitë në nivel lokal do të identifikohen para përpjekjes për zbatim në gjithë vendin.

4. ANALIZA E STRATEGJISË

Gjatë procesit të hartimit të Strategjisë, ishte e qartë nga informacionet ekzistuese dhe dokumentet e ndryshme të publikuara, se Kosova edhe për një kohë do të përballet me vështirësi sociale, ekonomike përgjatë afatit të zbatimit të Strategjisë dhe më tej. Identifikimi i çështjeve, problemeve dhe mundësive të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë u dëshmua të jetë largpamës. Në përgjithësi këto çështje janë shprehur në terma të përgjithshme.
Duke u lidhur me veprimet e cekura në raportet e mëparshme dhe strategjitë e tjera, ishte e nevojshme të kërkoheshin veprime më të qarta dhe specifike, të cilat mund të prioritetizohen pa kërkuar burime financiare shtesë të cilat mund të mos jenë në dispozicion. Qasja e përgjithshme strategjike parasheh implementimin e Strategjisë duke ndërmarrë veprimet në vijim:

4.1. Të vazhdohet me informacionet të cilat tashmë janë në dispozicion

Është e qartë që inventarizimi për llojet e bimëve dhe shtazëve është i vjetruar dhe jo i plotë. Gjithashtu, të dhënat për biodiverzitetin e Kosovës janë të pamjaftueshme për nisjen e procesit të ruajtjes së biodiversitetit. Në të njëjtën kohë, mund të zbatohen programet për përmirësimin e bazës së të dhënave nga të cilat varet ruajtja. Grupe të ekspertëve ekzistojnë brenda Universiteteve dhe OJQ-ve. Duke pritur një inventar të plotë, siç ndodh në disa shtete, kjo thjeshtë çon në humbje të mëtejme të biodiversitetit.

4.2. Afatet kohore

Zbatimi i Strategjisë do të marrë së paku 10 vjet të kohëzgjatjes së parashikuar, e me siguri edhe më gjatë. Kjo nënkupton një analizë më të kujdesshme të asaj se çfarë duhet bërë së pari, dhe çfarë burimesh financiare duhet siguruar.

4.3. Të ndalet humbja e mëtejme e biodiversitetit

Arritja e një shkalle ku ndalohet humbja e mëtejme e biodiversitetit do të jetë e vështirë për t'u definuar. Sidoqoftë tashmë dihet mjaft lidhur me shpërndarjen e florës dhe faunës në Kosovë për të përcaktuar atë që është e nevojshme për të shmangur humbjet e mëtejme. Qasja e cila përcillet brenda kësaj Strategjie e ka për synim të identifikojë se cilat veprime janë të nevojshme të ndërmerren për të shmangur humbjet e mëtejme.

4.4. Zbatimi

Prioritet për zbatimin është që të fillohet me ato fusha ku veprimet kanë gjasë të jenë të suksesshme. Zbatimi i të gjitha veprimeve të përcaktuara me Plan të Veprimit – edhe pse ato janë të prioritetizuara – mund të jenë të realizueshme përmes një varg hapash ose fazash, veçanërisht duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat përballet Kosova. Është e rëndësishme që veprimet të cilat ndërmerren në nivel lokal të fitojnë mbështetjen dhe angazhimin e komunitetit lokal.

4.5. Ndarja e përgjegjësive

Përgjegjësia për çështjet që kanë të bëjnë me biodiversitetin udhëhiqet nga MMPH-ja. Ministritë dhe Agjencitë tjera kanë gjithashtu përgjegjësi kur veprimet e tyre kanë të bëjnë me natyrën gjatë ushtrimit të veprimtarisë të tyre. Gjatë hartimit të Strategjisë nevojitet që pronarët e tokave private, bizneset dhe publiku të kuptojnë pjesën e tyre të përgjegjësive në ruajtjen e trashëgimisë natyrore të Kosovës. Arritja e synimeve të cilat identifikohen nga Strategjia do të përfshijë një spektër të institucioneve dhe individëve shumë më të gjerë se sa MMPH-ja.

4.6. Integrimi

Siç është cekur tashmë, pjesa më e madhe e përgjegjësive për ruajtjen e biodiversitetit bie mbi institucionet e përfshira: Ministritë tjera, komunat, popullata lokale kurse roli udhëheqës i takon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Integrimi dhe dialogu me Ministritë dhe komunat tjera duhet të rritet dhe zhvillohet, veçanërisht nëse konsiderojmë se detyrimet ndaj biodiversitetit sipas Kushtetutës të Republikës së Kosovës duhen realizuar. Strategjia ka për synim të përcaktojë përgjegjësitë për biodiversitetin tek të gjitha institucionet publike.

4.7. Gjuha dhe përmbajtja

Strategjia duhet të jetë lehtë e lexueshme dhe e kuptueshme për të gjithë ata përfshirja e të cilëve është vendimtare. Prandaj, gjuha e saj është vetëm aq teknike sa të jetë e nevojshme, p.sh. përdorimi i emrave latin për bimët dhe kafshët.

4.8. Parimet e Strategjisë

Parimet bazë nga të cilat udhëhiqet kjo Strategji janë:

4.8.1. Biodiverziteti paraqet vlerë unike, të cilën Kosova duhet ta përdor si resurs për zhvillim të mëtejmë duke ndërmarr masat e duhura për inventarizim, ruajtje dhe përparim të këtyre vlerave.

4.8.2. Ruajtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiverzitetit të bëhet pjesë e politikave dhe legjislacionit të sektorëve tjerë të cilët shfrytëzojnë ose kanë ndikim në resurset natyrore.

4.8.3. Harmonizimi i veprimeve në ruajtjen e biodiverzitetit në nivel lokal dhe ndërkombëtar, të vetëdijshëm se vlerat e tijë janë pjesë integrale e biodiverzitetit në përgjithësi.

4.8.4. Përafrimi i legjislacionit do të arrihet përmes transpozimit të Rregulloreve dhe Direktivave relevante për ruajtjen e llojeve të egra dhe habitateve natyrore.

5. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

5.1. Vizioni:

Vizioni ynë për biodiverzitetin 2020 është të sigurohet begatia unike e bimëve, shtazëve dhe peizazheve e cila do të kontribuojë në rritjen e mirëqenies për popullin e Kosovës.

5.2. Objektivat strategjike:

Objektiva strategjike 1: Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale sipas standardeve të BE-së dhe zbatimi efektiv i saj.

Objektiva strategjike 2: Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative në baraspeshë natyrore.

Objektiva strategjike 3: Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshem i biodiverzitetit dhe ndarja e barabartë e përfitimeve.

Objektiva strategjike 4: Promovimi i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiverzitetin.

Pasi që ti kemi zhvilluar objektivat kyçe, vëmendjen do ta orientojmë kah zhvillimi i disa synimeve të cilat do ta mundësojnë zbatimin e secilës prej tyre. Synimet do të përpiqemi ti bëjmë: SMART: specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë.


6. RAPORTET E GRUPEVE PUNUESE

6.1. Llojet, vendbanimet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonat e mbrojtura

GJENDJA E BIODIVERSITETIT TË KOSOVËS

Kosova është jashtëzakonisht e pasur me lloje bimore duke pasur në konsideratë sipërfaqen relativisht të vogël. Janë identifikuar rreth 13 lloje bimore që rriten vetëm në Kosovë dhe përafërsisht 200 lloje që rriten vetëm në Ballkan. Numri total i llojeve bimore është më i madh se në disa shtete evropiane. Kjo llojshmëri është rezultat i ndërveprimit kompleks të faktorëve fizik, siç është dheu dhe klima të cilat krijojnë një llojllojshmëri të habitateve dhe kushteve për rritjen e bimëve. Në territorin e Kosovës janë rreth 24 lloje të bimëve të kërcënuara si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Këto janë kryesisht të koncentruar në zonat malore por dhe në ato fushore shih ShTOJCËN VII.
Faktorët të cilët krijojnë kushte të favorshme për këtë llojllojshmëri të bimëve në Kosovë tregojnë për një nivel të lartë të llojllojshmërisë së shtazëve brenda këtij territori relativisht të vogël.

Janë rreth 46 lloje të gjitarëve në Kosovë shumica me rendësi regjionale dhe globale.
Disa lloje të zogjve të ujit janë zhdukur si pasoje e shkatërrimit të ligatinave, ndotjes dhe degradimit të lumenjve. Gjuetia ka qenë shumë e lartë gjatë viteve të 1990-ta, kurse tani ka raporte për reduktim të gjuetisë ilegale me çka mendohet se ka ndikuar në shtimin e popullacioneve të shtazëve të rrezikuara nga gjuetia ilegale.
Pjesa më e madhe e pasurisë së biodiversitetit të bimëve dhe shtazëve, gjendet në bjeshkët e larta të pjesës jugore dhe perëndimore të Kosovës[1].
Biodiverziteti i ekosistemeve lumore është zvogëluar seriozisht veçanërisht për sa i përket llojeve të peshqve si rezultat i ndotjes së ujërave dhe degradimit të shtretërve të lumenjve.



Burimi: Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës, Pikat e nxehta të biodiverzitetit në botë

Indikatorët e Biodiverzitetit


Në Kosovë mungojnë indikatorët kombëtar të biodiverzitetit, kjo krijon pengesa në shfrytëzimin e të dhënave dhe adresimin e çështjeve me prioritet kombëtar. Këta indikator do të shërbenin si vegla me të cilat do të vlerësohet statusi dhe kërcënimi për biodiverzitetin. Indikatorët do të ndihmojnë në përcaktimin dhe monitorimin e politikave kombëtare për biodiverzitetin, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për raportimin për zbatimin e Marrëveshjeve ndërkombëtare siç janë Konventa për Biodiverzitetin (KBD) dhe Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM).

Flora dhe vegjetacioni

Bazuar në hulumtimet e deritanishme në Kosovë janë inventarizuar rreth 1800 lloje të florës vaskulare, mirëpo supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në rreth 2500 lloje.
Pra edhe më tutje nuk kemi një inventar të plotë të florës dhe vegjetacionit. Vegjetacioni i Kosovës është i përfaqësuar më 139 asociacione bimore të grupuara në 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa. Qendrat e biodiversitetit të florës në Kosovë konsiderohet të jenë: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Koritniku, Pashtriku, Kozniku, Blinaja, Germia dhe Malet e Kopanikut. Një listë e llojeve endemike vaskulare në territorin e Kosovës do të paraqitet në ShTOJCA IV

[1] Final report Kosovo biodiversity assessment submitted by USAID may 2003

Harta e zonave të rëndësishme të bimëve



Burimi: Raporti fillestar teknik i identifikimit të zonave Natura 2000 në Kosovë

Fauna

Pyjet e larta dhe ekosistemet malore të Kosovës ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e popullacioneve të rëndësishme të gjitarëve të mëdhenj si: Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqare dhe këngëtarë mjaftë të rëndësishëm për ornitofaunën e Kosovës, Ballkanit dhe Evropës.

Në kuadër të zonave të mbrojtura ekzistojnë dy rezervate strikte në të cilat janë të mbrojtura dy lloje shtazore. Rezervati i Rusenicës në komunën e Suharekës, vendbanim i Rrëqebullit *(Lynx lynx)* dhe Kozhnjari në komunën e Deçanit, vendbanim i Dhisë së egër (Rupicapra rupicapra) këto dy lloje janë të rralla dhe të kërcënuara në nivel Evropian.


Në kuadër të faunës, vend me rëndësi zënë edhe shpezët me rreth 180 lloje. Zonat më të pasura me shpendë janë "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Malet e Sharrit" por të rëndësishme janë edhe liqenet dhe moçalet e Kosovës si vende pushimi gjatë rrugëve migratore për shumë lloje të shpendëve shtegtare.

Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), Fajkoi thonj bardhë (*Falco naummani*), Pulegra (*Tetrao urogallus*) janë disa nga llojet më reprezentative të vendit tonë të cilat janë të rrezikuara edhe në nivel botëror.

Territoret më të pasura me faunë janë: "Malet e Sharrit", "Bjeshkët e Nemuna", "Kopaoniku", "Malet e Moknës",dhe masivet tjera malore, lumenjtë dhe liqenet.

Sipas hulumtimeve të deritanishme në Kosovë jetojnë mbi 250 lloje të egra të kurrizorëve si dhe numër i madh i jo kurrizorëve.

Tabela e llojeve të rëndësishme ndërkombtarisht të përfshira në listen e IUCN dhe Listen e kuqe Evropiane



Burimi Raporti Gjendja e Natyrës 2006 - 2007 AMMK

Mbrotja "in – situ" e biodiverzitetit - Zonat e Mbrojtura të Natyres

Klasifikimi i zonave të mbrojtura bëhet sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës (Rregullorja 2006/22).
Zonë e mbrojtur e natyrës është zona e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peizazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve të tjera.
Kategorizimi i Zonave të Mbrojtura në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës është bërë sipas Unionit Botëror për Ruajtjen e Natyrës IUCN[2].
Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura përbëhet prej 97 zonave të natyrës me sipërfaqe 47.842.34 ha ose 4.39 % e territorit të Kosovës dhe mbi 195 zona të propozuara për mbrojtje përfshire këtu edhe Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me siperfaqe 62.488 ha.
Në kuadër të zonave të mbrojtura hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës,1 Park Kombëtar, 82 Monumente të Natyrës, 2 Parqe Regjionale të Natyrës dhe një Park pylli.

Tabela e zonave të mbrojtura të natyrës

Kategoria	Emërtimi	Nr. i zonave	Sipërfaqja/ha
I	Rezervate të natyrës	11	846.92
	RN Botanike	6	
	RN Zoologjike	2	
	RN Speciale	3	
II	Park Kombëtar	1	39.000.00
III	Monument natyre	82	6.296.93
	MN Speleologjike	4	
	MN Hidrologjike	15	
	MN Gjeomorfologjike	7	
	MN Botanike	55	
	MN Memoriale	1	
V	Park regjional – Peizazh i mbrojtur	2	1.683.49
	Park Pylli	1	15.00
Totali		97	47.842.34

Burimi Raporti Gjendja e Natyrës 2008 - 2009 AMMK, Prishtinë, 2010

[2] IUCN - International Union for Conservation of Nature, është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1948

I. **Rezervati Strikt i Natyrës -** zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime shkencore.

II. **Parku Kombëtar -** zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të mbrojtjes së ekosistemeve dhe rekreacionit.


III. **Monumenti Natyror -** zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.

IV. **Zona Menaxhuese e Habitateve ose Llojeve të Mbrojtura** - zonë e mbrojtur për ruajtjen e habitateve ose llojeve të mbrojtura.

V. **Peizazhet e Mbrojtura -** zonë e mbrojtur për qëllime të ruajtjes së peizazheve.


VI. **Zona e Mbrojtur e Resurseve Natyrore -** zonë e mbrojtur me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve natyrore.

Harta e Zonave të Mbrojtura të Natyres



Burimi Raporti Gjendja e Natyrës 2008 - 2009 AMMK, Prishtinë, 2010

Lista e Zonave të Mbrojtura të Natyrës në ShTOJCËN X.



Burimi Raporti Gjendja e Natyrës 2006 - 2007 AMMK

Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura të Natyrës

Momentalisht ekzistojnë organe menaxhuese vetëm në disa zona të mëdha të mbrojtura , ndërsa shumica e tyre nuk kanë organe menaxhuese.
Menaxhimi me Parkun Kombëtar "Mali Sharr" bëhet nga Drejtoria e Parkut e cila e ka selinë në Prizeren. Parku Regjional "Gërmia" menaxhohet nga ndërmarrja publike "Hortikultura". "Shpella e Gadimës" nuk menaxhohet nga Qeveria (Vendimi Nr. 04/57 të datës 13.03.2009). Ndërsa pë zonat tjera të mbrojtura nuk ka të themeluara drejtori per menaxhimin e tyre por menaxhohen nga autoritetet komunale përkatëse. Asnjë nga zonat e mbrojtura të natyrës nuk ka plan të menaxhimit, ekzistojnë shënime për vlerat e mbrojtura natyrore të këtyre zonave në IKMN.
Procesi i harmonizimit dhe kategorizimit të zonave duhet të bëhët sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, tani shpesh hasim në emërtime të ndryshme për një zonë të njejtë. Është duke u punuar regjistri qendror i zonave të mbrojtura.

Mbrojtja "ex - situ" (jashtë vendbanimit natyror) e biodiverzitetit

Me qëllim të ruajtjes së biodiverzitetit jashtë vendit ku ai gjendet në natyrë, gjerë më tani është punuar fare pak. Në Kosovë ende nuk kemi kopshte botanike, arboretume e as ndonjë kopsht zoologjik ose programe për kultivimin, mbajtjen e llojeve të rralla dhe të kërcnuara në internim.
Ka disa përpjekje që të krijohet Banka e gjeneve në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës.
Deri më tani nuk ka pasur praktika institucionale për mbrojtjen e llojeve "ex - situ", përkundër këtij fakti, ekzistojnë disa iniciativa private për mbajtjen e disa llojeve të faunës së egër nëpër të ashtuquajturat "mini - kopshte zoologjike", përkatësisht vendet në të cilat mbahen lloje të rrezikuara të faunës. Janë evidentuar llojet, numri i individëve si dhe kushtet në të cilat mbahen këto shtazë. Këto nuk i plotësojnë kriteret për mbajtjen e këtyre shtazëve, këto "mini kopshte" janë të ngritura afër restoranteve të ndryshme dhe kanë për qellim të tërheqin vizitorët.


Mbajtja e Ariut të murrëm (Ursus arctos Linn.) në "kafaz" tek Restorant Freskia Gërmi

Identifikimi i zonave potenciale për NATURA 2000 në Kosovë

Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian (BE) dhe ende nuk është e detyruar të bëjë paraqitjen e zonave për rrjetin ekologjik "NATURA 2000". Mirëpo përgatitja për hyrje në BE kërkon kohë dhe krahas përmbushjes së standardeve të tjera, mbrojtja e mjedisit dhe natyrës zënë një vend të rëndësishëm. Prandaj, duke e ditur se përmbushja e këtyre kritereve kërkon një kohë të gjatë, fillimi i identifikimit të këtyre zonave duhet të jetë me prioritet.
Projekti për identifikimin e zonave potenciale të cilat i plotësojnë kriteret për të hyrë në rrjetin ekologjik "NATURA 2000" ka filluar në kuadër të "Projekti i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve" (PMQP), Raporti i hartuar është fillestar dhe nevojiten studime të mëtejshme [3].

Iniciativa "Bjeshkët e Nemuna" Park Ndërkufitar, Kosovë – Shqipëri - Mali i Zi

Nisma për shpalljën e Parkut Ndërkufitar në trekëndëshin e kufirit Kosovë – Shqipëri - Mali i Zi ka rrjedhë nga shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare. OJQ "Aquila" Pejë– Kosovë, OJQ "Intelektualët e Rinj Shpresë" Shkodër-Shqipëri, OJQ "Hali" Rozhajë-Mali i Zi kanë bërë hapat e parë në këtë drejtim, ku më pas kanë gjetur mbështetjen e një numri aktivistësh nga Universitetet Colgate në SHBA dhe Bradford të Mbretërisë së Bashkuar.
Qëllimi i kësaj iniciative është ruajtja e shumëllojshmërisë së trashëgimisë natyrore, kulturore, promovimi i paqes dhe harmonisë në mes njerëzve dhe natyrës dhe të mundësojë lëvizjen e lirë përtej kufijve politikë duke mundësuar zhvillimin e qëndrueshëm.
Harta e Parkut Ballkanik të Paqes është dhënë në ShTOJCËN IX.

[3] Identifikimi paraprak i zonave të Natura 2000 në Kosovë

Mbrojtja e peizazheve

Nga pikëpamja gjeologjike Kosova është e vendosur në një territor shume interesant. Zona e Kosovës është e karakterizuar nga një larmi formacionesh gjeologjike. Duke filluar nga shkëmbinjtë e vjetër kristalin të Proterozoikut deri në shkëmbinjtë e moshës Kuaternare, që përfshijnë lloje të ndryshme të shkëmbinjve sedimentar, magmatik dhe shkëmbinjë metamorfik që janë më pak të përhapur. Bazuar në shënimet në dispozicion Kosova edhe në të kaluarën i ka kushtuar vëmendje mbrojtjes së peizazheve duke i shpallur nën mbrojtje ligjore disa të cilat janë konsideruar më të rëndësishme si: Mirusha, Gërmia, mandej monumentet natyrore me rëndësi gjeologjike, hidrologjike, peizazhore, speleologjike dhe botanike Gryka e Rugovës, Gryka e Lumëbardhit etj. gjatë zhvillimeve në këto zona posaçërisht i kushtohet kujdes Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për aktivitetet e planifikuara. Kosova ende nuk është nënshkruese e Konventës për peizazhet evropiane (Firence 2000) por në periudhën e kohëzgjatjes së kësaj Strategjie do të bëhet vend anëtarë andaj fillimi i përgatitjeve për krijimin e një bazë e të dhënave për gjendjen e peizazheve në përgjithësi duhet të ndërmerren.

Mineralet dhe fosilet

Kosova karakterizohet nga një ndërtim i ndërlikuar gjeologjik, i cili ka kushtëzuar edhe krijimin e një spektri të gjerë të vendburimeve të mineraleve metalore, jo metalore, të burimeve energjetike, materialeve inerte dhe ujërave të ndryshëm nëntokësore.
Burimet minerale metalore janë të përfaqësuara me një numër të madh të llojeve të ndryshme mineraleve si: plumb, zink, hekur, nikël, krom, boksit, mangan, antimon, etj.
Burimet minerale jo metalore dhe mineralet inerte në Kosovë janë disa herë më shumë për nga numri se sa ato mineraleve metalore: magnezitet, kolinë, mergele të çimentos bentonitet, dunite, tufe, gëlqerore, kuarcit, rëra kuarcore, talk, azbest, diabazdiabaz, rërë argjile, etj.

6.1.1. Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet, si dhe mungesa e Listës së Kuqe;
- Mungesa e indikatorëve kombëtar të biodiverzitetit;
- Mungesa e organeve menaxhuese, planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Buxheti i pamjaftueshëm për mbrojtjen e natyrës dhe mungesa e mekanizmave për thithjen e fondeve ndërkombëtare.

6.1.2. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Hulumtimi, inventarizimi dhe paraqitja hartografike e llojeve, habitateve dhe peizazheve;
- Zvoglimi i shkallës së humbjes së biodiverzitetit përmes shtimit të sipërfaqës së zonave të mbrojtura në rreth 10%;
- Shpallja e zonave të mbrojtura të identifikuara si zona IBA (Important Bird Area) dhe NATURA 2000;
- Nxjerrja e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura duke respektuar kushtet për mbrojtjen e natyrës;

- Zhvillimi i indikatorëve kombëtar të biodiverzitetit;.

6.2. Edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut

Edukimi

Nevoja për ngritjen e vetëdijes për rendësin e biodiverzitetit është një proces i arsyeshëm, përfitimet dhe kërkesat e të gjitha palëve të përfshira, të cilat kanë shkallë të ndryshme edukimi shton nevojën e edukimit dhe komunikimit. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës shpesh nuk kuptohet drejtë nga sektori privat, se cilat janë efektet e ndërhyrjeve të tyre në biodiverzitet dhe si të menaxhohen ato. Prandaj është me rendësi vitale që të trajnohen të gjitha palët e interesuara për një komunikim efektiv për çështjet e menaxhimit të biodiverzitetit.
Kosova ka biodiversitet të pasur, këtë e kanë mundësuar: pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima.
Inventarizimi i specieve, si të florës ashtu edhe të faunës nuk është përfunduar, ende nuk është përpiluar/hartuar/ Libri i Kuq. Florën dhe faunën e Kosovës e bëjnë të rëndësishme dhe atraktive një numër i madh i llojeve endemike, relikte dhe subendemike. Një numër i tyre është i kërcënuar për zhdukje.
Vendi ynë ende po përballet me probleme socio-ekonomike, dhe si pasojë edukimi për biodiversitetin konsiderohet si problem dytësor në procesin e edukimit të përgjithshëm. Janë bërë disa hapa në edukimin për Mjedisin dhe Biodiversitetin, dhe po përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, sepse kemi detyrim që brezave të ardhshëm t'iu lëmë një diversitet biologjik dhe peizazhor po aq të pasur sa kemi trashëguar ne. Andaj Edukimi i brezave të ardhshëm për rëndësinë e biodiversitet është prioritet i MMPH-së.
Edukimi, informimi dhe komunikimi është hapi i parë në procesin e ndryshimeve sociale që ndihmon të kuptuarit e rëndësisë së diversitetit biologjik dhe peizazhor, dhe ndikon për të ndryshuar qëndrimin e publikut, sjelljet, duke marrë përgjegjësinë dhe përfshirjen në mbrojtjen e tij.
Për të nxitur interesimin në mbrojtjen e natyrës si dhe nevojën për ruajtjen e saj, programet ekzistuese shkollore duhet të plotësohen me përmbajtje dhe mësimdhënie (punë praktike ne terren) duke vënë theksin mbi edukimin për vlerat natyrore.
Në fushën e edukimit Sektori i edukimit dhe ndergjegjsimit mjedisor ka bërë hapa pozitiv, ka kontribuar që lënda mbrojtja e mjedisit të përfshihet në kurrikulet shkollore, ka botuar një mori materiale didaktike, si dhe ka zhvilluar orë edukative mjedisore, dhe ende vazhdohet në shkolla në gjithë Kosovën.
Qëllimi i edukimit, informimit dhe pjesëmarrjes të publikut është të ndihmojë në arritjen e objektivave të Strategjisë së Biodiversitetit. Pra, të inkurajojë dhe zhvillojë format e edukimit në të gjitha nivelet institucionale dhe jo-institucionale për të gjitha grupet e qytetarëve në mbrojtjen e biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore.
Bashkëpunimi në mes të MMPH-së dhe MASHT-it është e rregulluar me Memorandumin e bashkëpunimit e nënshkruar nga dy ministritë. Janë mbajtur seminare verore me personelin arsimor pothuaj në gjithë Kosovën në të cilat janë shpërndarë materiale të ndryshme didaktike si për nxënës po ashtu edhe për personelin arsimor.
Nga viti 2001, shkollat në Kosovë mësojnë me kurrikul të ri. Kurrikuli është hartuar në koherencë me reformën e sistemit të edukimit, nga 4+4+4 në 5+4+3(4). Janë zhvilluar edhe të gjitha kurrikulat lëndore. Në kurrikul mbrojtja e mjedisit është përfshirë si lëndë zgjedhore, ndërsa përmbajtjet mjedisore përfaqësohen si përmbajtje ndër-kurrikulare. Pra, Biodiversiteti nuk mësohet si lëndë e veçantë por mësohet në kuadër të lëndëve tjera,

duke filluar në shkollën fillore që nga Klasa e III –V ku merren informatat e para për mjedisin dhe biodiversitetin nga lënda Njeriu dhe Natyra dhe pastaj në shkollën e mesme të ultë prej Kl. VI-IX elementet e biodiversitetit përfshihen në lëndën e biologjisë dhe lënda Mbrojtja e Ambientit jetësor si lëndë zgjedhore (Kl.VI-IX) në këto lëndë mësohet vetëm nga një kapitull por jo më shumë do të thotë nga 3 eventualisht 4 orë mësimore. Gjithashtu për Biodiversitetin mësohet edhe në shkollën e mesme të lart nga Kl. X-XIII.

Në kurrikulin për shkollat e mesme të larta profesionale, nga viti shkollor 2003/2004 në klasën e 13, përfshihet lënda Mbrojtja e Ambientit, dhe në një modul është përfshirë biodiversiteti.

Në Universitetin e Prishtinës në FSHMN, në Departamentin e Biologjisë është hapur Drejtimi për Ekologji, ku në kuadër të kësaj mësohet edhe biodiversiteti, ndërsa në disa departamente të tjera të po këtij fakulteti Mbrojtja e mjedisit mësohet si lëndë, si në departamentin e Biologjisë, të Kimisë (Kimia e mjedisit), të Gjeografisë dhe në Fakultetin e Edukimit etj.

Sa i përket vëllimit të përfshirjes së temave mjedisore mund të jemi të kënaqur (diku rreth 5% nga vëllimi i përgjithshëm i kushtohet mjedisit, por nuk jemi të kënaqur me cilësinë e përfaqësimit dhe cilësinë e zbatimit në praktikë me nxënës. Mungon qasja praktike dhe atraktive e mësimdhënies dhe e aktivizimit të nxënësve dhe të rinisë shkollore në aktivitetet mjedisore në shkollë dhe në rrethinën ku vepron shkolla. Mungon qasja vullnetare si dhe shoqëria civile e papërvojë për një veprim më të fuqishëm në komunitet.

Përpilimi i programeve dhe projekteve të edukimit si dhe përfshirjes së gjerë të publikut dhe popullsisë lokale në procesin e planifikimit dhe menaxhimin e biodiversitetit duhet të zhvillohet më tej, inkurajohet dhe zbatohet në të ardhmen.

Këto programe duhet të përshtaten sipas grupeve të moshave, profesioneve dhe interesave të publikut të cilit i adresohet. Edukimi për biodiversitetin duhet të nisë që nga moshat parashkollore ndërsa përparësi duhet dhënë punës me fëmijët dhe nxënësit e shkollës fillore.

Bashkëpunimi me MASHT, Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe shkollat duhet të fuqizohet. Prodhimi i më shumë materialeve didaktike mbi biodiversitetin dhe mjedisin në përgjithësi, rritja e cilësisë së informatave për të gjitha shtresat e qytetarëve është e një rëndësie vitale. Krijimi i grupeve dhe shoqatave mjedisore-ekologjike duhet të zë vend në të gjitha shkollat dhe nivelet e edukimit në Kosovë. Për përmirësimin e gjendjes së biodiversitetit duhet të kihen parasysh që:

- Në shkollat tona mungojnë aktivitetet për krijimin e shprehive të mbrojtjes së biodiversitetit.
- Edukimi nënkupton krijimin e një qëndrimi pozitiv dhe të menduarit kritik karshi ndodhive mjedisore dhe në veçanti të biodiversitetit, i cili do të fuqizohet.
- Edukimi mbi biodiversitetin është mjaft kompleks, për ngritjen e vetëdijes me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes, menaxhimin dhe përfitimin nga diversiteti biologjik dhe peizazhor
- Format e edukimit jashtë shkollës në fushën e biodiversitetit dhe veçanërisht të disa grupeve të interesit (bujqësi, pylltari, gjueti, peshkim, menaxhim ujërash, transport, energji, turizëm, etj) pothuajse nuk ekzistojnë.
- Bashkëpunimi me zyrat rajonale (komunale) për edukim dhe kulturë si një element kryesor për koordinimin e njësive operative për implementimin e projekteve dhe programeve të edukimit mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit nuk është i kënaqshëm.

Aktivitetet e sektorit janë kryesisht të orientuara në fushën e edukimit dhe promovimit të problemeve mjedisore dhe çështjeve që i preokupojnë qytetarët, në aspekt lokal dhe global. Ato janë zhvilluar kryesisht në shkolla, nivele primare dhe sekondare, OJQ, organizata rinore dhe institucione përkatëse janë pasuruar me materiale informative dhe didaktike.

6.2.1. Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e fondeve për edukim mjedisor;
- Qëndrimi pasiv i qytetareve ndaj biodiversitetit;
- Mungesa e trajnimeve të mësimdhënësve në të gjitha nivelet për çështje të biodiversitetit;
- Programe dhe materiale jo të mjaftueshme për edukim për biodiversitetin;
- Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe OJQ-ve për edukimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

6.2.2. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Shfrytëzimi i mjeteve financiare në formë më efikase dhe gjetja e burimeve tjera;
- Ndryshimi i qëndrimit të popullatës ndaj biodiversitetit, përmes promovimit të rëndësisë së ruajtjes së llojeve të kërcnuara (për shembull shqiponjat = simbol kombëtar, Dhia e egër, lule Bozhuri);
- Plotësimi dhe zbatimi i kurrikulave në të gjitha nivelet;
- Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe OJQ-të për edukimin mjedisor.

Komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje ngritë cilësinë dhe implementimin e vendimeve mjedisore. Duke çmuar rolin e qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat në mbrojtjen e mjedisit legjislacioni vendor e rregullon të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes dhe të drejtën për t`iu drejtuara gjykatës për çështjet që lidhen me mjedisin sipas Konventës të Aarhus – it/ 1998. Në bashkëpunim me OJQ-të, komunat, etj. janë organizuar takime dhe diskutime me publikun në projekte të ndryshme, siç janë; Ligjet, Strategjitë, Planet hapësinore etj. Nuk mund të jemi të kënaqur në këto fusha, veçanërisht me pjesëmarrjen dhe informimin e publikut, por edhe me idetë dhe alternativat e ofruara për çështjet e rëndësishme për qytetarët dhe mjedisin.
Konventa është e nevojshme për procedurat publike që do t'i mundësonin publikut të parashtrojë komente, informacione, analiza ose opinione (me shkrim, ose në formë gojore gjatë takimeve publike, ose në formë kërkesash nga aplikantët), gjë që mund të jetë relevante për aktivitetet e propozuara për të përfshirë më shumë preferenca që dalin nga pjesëmarrja e publikut.
Shfrytëzimi dhe menaxhimi i informimit në fushën e biodiversitetit vlerësohet si përparësi shumë e lartë për Kosovën. Përdorimi dhe menaxhimi i informacioneve në sferën e biodiversitetit vlerësohet si një përparësi tjetër e madhe për shkak të mungesës së një sistemi të organizuar dhe operativ në vend. Duke pasur parasysh, shkëmbimin operativ dhe përdorimin e informatave ekzistuese të sakta kursen kohë, para dhe energji. Kësaj lëmije nuk i është kushtuar vëmendje e duhur në të kaluarën.
Lidhur me informimin, janë ndërmarrë hapa pozitiv, por jo të mjaftueshëm. Përveç publikimit të materialeve informative, broshurave, fletëpalosje, panove të ndryshme,

sektori ka marrë pjesë gjithashtu në programe të stacioneve kombëtare dhe lokale të radios dhe televizionit.
Mediet e shtypura dhe elektronike nuk kanë programe/seksione/ të rregullta informative mbi mjedisin dhe biodiversitetin. Informimi kryesisht bëhet në rastet e aksidenteve ekologjike, etj. por jo edhe në formë të informimit të rregullt dhe parandalimit. Një pjesë e informimit bëhet nga MMPH-ja, përmes medieve të shkruara, broshurave, revistave, fletëpalosjeve, panove, etj.

6.2.3. Problemet kryesore të identifikuara:

- Komunikimi dhe Informimi jo i mjaftueshëm i publikut lidhur me biodiversitetin;
- Vetëdijesimi dhe pjesëmarrja e ultë e publikut;
- Mungesa e koordinimit të sistemit të komunikimit dhe informimit ndërmjet institucioneve që kanë të bëjnë me biodiversitetin;
- Mungesa e ekspertizës profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit.

6.2.4. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Të zhvillohen fushata të ngritjes së vetëdijes publike për biodiversitetin me grupet e synuara veçanërisht të rinjët;
- Bashkëpunimi me media, nxjerrja e publikimeve tematike (fletushka, broshura, postere etj.);
- Krijimi i programit tre vjeçar për komunikim dhe informim për biodiversitetin me institucionet relevante;
- Ngritja e ekspertizës profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit të institucionet relevante.

SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BIODIVERZITETIT - RESURSEVE NATYRORE

Biodiverziteti paraqet bazën e jetës në Planetën tonë, por ai është degraduar në masë alarmuese nga presionet e njeriut, përmes shfrytëzimit të resurseve natyrore, ky degradim kyçë paraqet një kërcenim serioz për njerëzimin. Aktivitetet ekonomike janë shtytësit kryesor që qojnë në humbjen e biodiverzitetit por në të njëjtën kohë shumë aktivitete të biznesit varen nga biodiverziteti. Në parim, të gjitha bizneset kanë ndikim direkt ose indirekt në biodiverzitet.

6.3. Bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkataria dhe turizmi

Bujqësia

Sektori i bujqësisë është njëra nga "industritë" që bazohen në resurse natyrore dhe mund të sigurojnë përfitime për biodiverzitetin përmes aplikimit të sistemeve menaxhuese dhe aplikimin e teknologjive dhe praktikave miqësore për natyrën e posaçërisht përmes krijimit të rezervateve biologjike brenda fermave, zhvillimit të rrjetit të vendbanimeve natyrore për rreth dhe ndërmjet fermave, zvogëlimin e ndryshimit të vendbanimeve të egra natyrore në tokë bujqësore, duke lënë një pjesë të tokës bujqësore jashtë prodhimit me qëllim të ripërtëritjes së vendbanimeve natyrore dhe përdorimi i praktikave të qëndrueshme në blegtori dhe shfrytëzimin e kullotave.

Kosova karakterizohet si rajon rural me rreth dy të tretat e popullsisë që jetojnë në fshatra. Toka kryesisht është pjellore, por është shumë e degraduar nga aktivitetet minerare të KEK- ut, Trepçës dhe Feronikelit dhe deponitë industriale të tyre të cilat përmbajnë mbetje të metaleve të renda dhe si pasojë një pjesë e madhe e këtyre tokave nuk përdoren për prodhimtari bujqësore. Aktivitetet bujqësore në afërsi të këtyre deponive industriale janë ndikuar. Analizat e kulturave bujqësore dhe perimeve kan treguar se përqendrimet e metaleve të rënda janë të rritura. Përveç deponive industriale, deponitë urbane paraqesin kërcënim për humbjen e tokës bujqësore.
Ndikimi në shkallën e humbjes së biodiverzitetit nga aktivitetet bujqësore është relativisht i ulët për shkak se plehrat artificiale dhe pesticidet përdoren në sasi të vogla.
Bujqësia në Kosovë paraqet degën e ekonomisë e cila ka ndikim direkt ose indirekt në biodiversitet. Bujqësia në vitin 2004 ka kontribuar me rreth 25 % Prodhimit të Përgjithshëm Vendor (PPV) ndersa në vitin 2005 me rreth 19 %, aktualisht mbështet mbi 60% të popullsisë, kurse bashkë me pylltarinë japin 35 % të PPV. Shumë vendbanime natyrore gjatë viteve të 50-ta deri 70-ta të shekullit të kaluar janë kthyer në tokë bujqësore përmes hapjes së pyjeve me qëllim të krijimit të sipërfaqeve të tokës së lëvrueshme. Nga sipërfaqja e përgjithshme rreth 53 % (585.000 ha) është tokë e punueshme, 42% (464.800 ha) pyje dhe tokë pyjore ndërsa rreth 5 % tjera.
Toka e punueshme kryesisht mbillet me drithëra (misër, grurë, elb etj.) rreth 47,6 % e sipërfaqes, të kositura te gjelbërta 2,3 %, bimë foraxhere 41,1 %, perime 6,3 %, pemishte 2 % dhe tjera 1 %.
Pronësia mbi tokën ka qenë private në masë 87 %, kurse pjesa tjetër 10 – 13 % ka qenë në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Gjer me tani Agjencioni pë Privatizim i Kosovës i ka privatizuar rreth 70 % të siperfaqeve të gjithmbarshme të pronave të NSH-ve.
Toka në Kosovë është pjellore me klimë të përshtatshme (Rrafshi i Kosovës me klimë kontinentale me ndikim të klimës mesdhetare me të reshura vjetore rreth 600 mm dhe Rrafshi i Dukagjinit i cili karakterizohet me klimë mesdhetare me të reshura vjetore prej 770 mm) që garanton prodhimtari rentabile të ushqimit për nevoja të popullatës së vetë, por edhe për eksport të disa prodhimeve bujqësore.
Agrobiodiverziteti - paraqet llojllojshmërinë në mes të shtazëve, bimëve dhe mikroorganizmave të rëndësishme për prodhimtarinë bujqësore, gjegjësisht ushqimin e njerëzve dhe kafshëve.
Agrobiodiverziteti është fusha më kritike në biodiverzitetin e përgjithshëm, një pjesë e madhe e llojeve të bimëve përdoren për ushqim të njerëzve dhe kafshëve shtëpiake. Për nevoja të veta njeriu ka zbuluar varietetet më produktive të bimëve dhe raca më produktive të kafshëve shtëpiake me çka bimët dhe racat me produktivitet të ulët iu kanë nënshtruar zhdukjes. Në Kosovë duhet pas kujdes që këto lloje të ruhen qoftë edhe për qëllime shkencore, socio-ekonomike dhe mjedisore.
Është e njohur se shumë varietete të vjetra të grurit, misrit dhe pemëve për shkak të produktivitetit të ultë janë lanë pas dore dhe shumë pak janë të përfaqësuara, gjithashtu racat autoktone si busha, bardhoka, buallicat janë shumë pak të pranishme në fondin blegtoral si pasojë e importimit të racave më produktive të lopëve. Një vlerë të veçantë paraqet edhe qeni i Sharrit i cili është autokton në Kosovë dhe duhet ti kushtohet kujdes më i madh.

Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ)

Aktualisht në Kosovë nuk ka informata të kompletuara lidhur me praninë e OMGJ-ve qoftë me prejardhje bimore apo shtazore edhe pse përmes rrugëve jo legale mund të ketë

futje të tyre. OMGJ-të njëkohësisht paraqesin kërcenim për prodhimtarinë organike e cila po promovohet kohëve të fundit në Kosovë.
Kosova ende nuk ka laborator ku OMGJ- të do të testoheshin, që edhe më tepër e vështirëson këtë proces.

Prodhimtaria e disa kulturave më kryesore në 20 vitet e fundit në ton

Kultura/ vitet	1981	1986	1991	1996	2001	2008
Grurë	196.740	304.480	357.000	153.000	249.191	293.060
Misër	222.930	337.930	342.000	157.000	180.743	68.424
Miser kluturë e perzier						58.495
Patate	-	83.610	89.000	83.000	70.668	103.958
Domate	-	21.430	23.000	25.000	22.676	20.587
Speca	-	25.270	27.000	31.000	34.021	51.274
Mollë	-	18.960	10.000	16.000	2.282	12.612
Dardha	-	6.960	5.000	7.000	769	2.867
Kumbulla	-	14.750	13.000	24.000	2.941	10.901

Burimi:Vjetarët statistikor për vitet përkatëse & Anketa e ekonomive shtëpiake 2001 dhe 2008.

Blegtoria është nën sektori bujqësor që në vazhdimësi ka dhënë rezultate të mira në bujqësinë gjysmë komerciale në Kosovë.

Vlerësimi i gjendjes aktuale të blegtorisë është dhënë në tabelën vijuese.

Nr.	Lloji i kafshës	Njesia/krer	Numri / sasija	Pjesemarrja (%)
1.	Gjedhë	krerë	291.400	59
2.	Dhentë	“	122.000	25
3.	Dhitë	“	16.600	3
4.	Derra	“	53.000	11
5.	Kuajë	“	12.260	2
	Gjithsejt:		495.260	100
	Kategori tjera			
6.	Pula vojse	copë	900.000	100
7.	Bletët	koshere	70.000	100
8.	Peshk	ton	496	100

Burimi: Departamenti i Prodhimtarisë Bimore - MBPZhR 2009 Projekti për Regjistrimin dhe identifikimin e kafshëve shtepiake 2005.

Shfrytëzimi ekstensiv i kullotave dhe livadheve ka pasur ndikim pozitiv në pasurimin e biodiverzitetit e posaçërisht shfrytëzimi i livadheve të cilat në mbrojtjen e natyrës njihen si vendbanime përafërsisht natyrore.
Në shumë pjesë të Kosovës viteve të fundit nuk ka pasur interesim të popullatës për t’u marrë në mënyrë më intensive me bujqësi kështu që kjo ka krijuar një numër të madh të tokave në të cilat rritet vegjetacioni pyjor në dëm të livadheve dhe në këtë mënyrë është ndikuar edhe në humbjen e sipërfaqeve të tëra të livadheve dhe llojeve bimore e shtazore të lidhura me to. Me humbjen e këtyre vendbanimeve natyrore llojet e ndryshme kanë qenë të rrezikuara edhe nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve. Përdorimi i pesticideve në përgjithësi në Kosovë shpenzohen rreth 461 ton në vit, pesticide të ndryshme, prej tyre; Insekticide janë 306 t, Fungicide 106 t, Herbicide 3 t, Rodenticide 42 t, Akaricide 4 t. Tregu ynë furnizohet kryesisht nga importi dhe shpesh këto materie paraqesin rrezik potencial për ndotjen e mjedisit gjithashtu edhe përdoruesit shpesh nuk kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me pasojat e mundshme në mjedis nga përdorimi i tyre.

6.3.1. Problemet kryesore të identifikuara:

- Humbja e tokës bujqësore - rreth 1.000 hektar për vit konvertohet nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, që shkakton humbjën e biodiverzitetit;
- Ndotja aktuale dhe e trashëguar e tokës bujqësore;

6.3.2. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Të promovohen prodhimtaria ekologjike dhe bujqësia organike (shtimi i siperfaqeve dhe numrit të fermave);
- Të ruhen zonat me karakteristika reprezentative të vendbanimeve natyrore duke aplikuar bujqësinë tradicionale;
- Të zvogëlohet trendi i humbjes së tokës bujqësore - vendbanimeve natyrore;
- Të stimulohen prodhimet që mbeshtesin agrobiodiverzitetin dhe të ndalohet futja e llojeve të huaja invazive dhe OMGJ-ve në vendbanime natyrore;
- Te përfshihen në edukim për rendësin e ruajtjes së biodiverzitetit, fermerët posaçërisht lidhur me përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve me spektër të gjerë.

Pylltaria

Pyjet paraqesin ekosisteme të llojllojshme biologjike dhe njëkohësisht zonat më të pasura me biodiverzitet në botë. Ato ofrojnë llojshmëri të vendbanimeve për bimët, shtazët dhe mikroorganizmat. Përveç sigurimit të drurëve dhe prodhimeve tjera jo drunore pyjet luajnë rol mbrojtës, ruajtjen e ekosistemeve, mbajtjen e ujit të pastër, zvogëlimin e rrezikut nga vërshimet, ortekët, erozioni dhe thatësira.
Gjatë viteve 2003/2004 është zhvilluar një inventarizim i pyjeve në tërë vendin, për të plotësuar nevojën për informacione të azhurnuara të burimeve të pyjeve. Nga sipërfaqja e përgjithshme e klasifikuar si pyje dhe tokë pyjore 464.800 ha, rreth 379 200 ha janë klasifikuar si toka pyjore përmes interpretimit të aero fotove dhe anketimeve në terren. Të tjerat, 85 600 ha janë klasifikuar si toka pyjore përmes interpretimit të fotove, por nuk janë anketuar për shkak të minave dhe pengesave të tjera logjistike. Prej sipërfaqes totale të tokave pyjore që kanë qenë të anketuara dhe jo të anketuara, 278 880 ha janë klasifikuar si toka pyjore publike dhe 185 920 ha si toka pyjore private. Pyjet gjethrënse mbulojnë më shumë se 90 % të tokave pyjore. Llojet dominuese të gjetherënseve janë bungu dhe ahu. Pyjet halore mbulojnë 7 % të tokave pyjore dhe aty dominojnë bredhi, hormoqi dhe pisha. Vëllimi total në këmbë në pyjet publike është vlerësuar të jetë rreth 33.5 milion m^3. Prej këtij vëllimi, 25.9 milion m^3 janë drunj me diametër >7 cm, në lartësi të gjoksit. Në pyjet private, vëllimi total në këmbë është vlerësuar rreth 19.5 milion m^3 prej të cilave 14.5 milion m^3 janë drunj me një diametër >7 cm.
Rritja vjetore e drunjve në sipërfaqet e anketuara dhe me diametër >7 cm, në lartësi të gjoksit, është kalkuluar të jetë 1.165 milion m^3. Ndërsa për sipërfaqet e pa anketuara (85. 600 ha) që në masë të madhe gjenden afër fushave të minuara apo pjesëve të pavizituara, duket e arsyeshme që të mos përfshihet kjo rritje në bazat për prerje të lejueshme vjetore.
Është një sipërfaqe e konsiderueshme e tokave pyjore të zhveshura (20.000 – 30.000 ha). Disa nga këto sipërfaqe janë të prekura nga erozioni dhe kanë një shtresë të vogël të dheut, një pjesë e konsiderueshme është e përshtatshme për pyllëzime.
Rreth 40% e tokave pyjore publike dhe 29% e tokave pyjore private u janë nënshtruar aktiviteteve të pakontrolluara apo ilegale të shfrytëzimit. Krahasuar me të gjitha standardet e aplikuara, këto shifra janë mjaft të larta. Situata është shumë kritike sidomos

në pyjet halore, ku ekzistenca e sipërfaqeve të tëra pyjore është vënë në rrezik, nëse nuk merren masa të menjëhershme. Rezultatet e inventarizimit gjithashtu konfirmojnë që pyjet e ulëta, veçanërisht ato publike i shtrohen një shfrytëzimi të tepërt. Po ashtu, rezultatet tregojnë, që shumë pyje të reja dhe ato me moshë mesatare të mesme kanë nevojë urgjente për intervenime silvikulturale, duke filluar prej rrallimeve parakomerciale deri tek rrallimet komerciale. Ndikimet e ndërhyrjeve ilegale në pylltari janë evidente e posaçërisht shkatërrimi i bimëve mjekësore dhe aromatike për qëllime komerciale do të ketë ndikim të dukshëm në humbjen e llojeve të cilat janë të rralla dhe të kërcnuara.
Grumbullimi i bimëve mjeksore dhe aromatike, frutave të egra të malit si dhe kërpudhave shpesh bëhet pa kritere gjë që shkakton presion në biodiverzitet.
Bimët mjeksore të cilat më shpesh shfrytezohen janë: Sherbela mjekësore (*Salvia officinalis),* Dëllinja e zezë (*Juniperus communis L.), Akësi (Helichrysum italicum L.), Aguliçja (Primula veris L.) Shtogu (Sambucus negra),* Rrush arushe (*Arctostaphylos uva ursi L), Bliri (Tilia cordata Mill.),* Trëndafili i egër (*Rosa canina L.).*
Frutat e egra si: Boronicat (Vaccinium myrtillus), mjedrat, dredhezat;
Kërpudhat si Vrganji (*Boletus edulis*) dhe Dhelprusha (*Cantharellus cibarius*).
Për sasitë të cilat mblidhen nuk ka ndonjë shënim të saktë por operohet me shifra të përafërta, duke pas parasysh se edhe korniza ligjore për këtë lëmi nuk është e kompletuar duhet që sa më parë të krijohet baza ligjore me qellim të zvogëlimit të ndikimit nga grumbullimi i bimëve mjekësore dhe aromatike në humbjen e biodiverzitetit.





Shtrirja e pyjeve në Kosovë Prerja e pyjeve ne Rugovë
Burimi AKMM Raporti i gjendjes së natyres 2006 – 2007

6.3.3. Problemet kryesore të identifikuara:

- Zbatimi i dobët i Ligjit për Pyjet e Kosovës
- Menaxhim i dobët me pyjet - mungesë e institucioneve efikase për zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për pyjet;
- Përgjegjesitë e padefinuara në rrafshin horizontal dhe vertikal për menaxhimin me pyjet;
- Mungesë e Planeve Menaxhuese për pyjet e Kosovës (planeve menaxhuese aktuale iu ka kaluar afati kurse të rejat po nxirren me vështirësi);
- Kosova ende nuk e ka miratuar Certifikimin e pyjeve sipas standardeve ndërkombëtare – FSC (SKMP).

6.3.4. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Menaxhimi me pyjet të behët në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm duke shfrytëzuar 60 % të shtimit vjetor dhe të ndërmerren pyllëzime në toka të zhveshura pyjore me lloje autoktone;
- Shpallja dhe menaxhimi i efektshëm i zonave të mbrojtura do të bazohet në kritere të pranueshme ndërkombëtare, sikur edhe një planifikim i mirëfilltë, përfshirë ekspertizën e nevojshme dhe palët relevante të interesit;
- Të ndërpriten veprimet ilegale në pyje të cilat ndikojne në degradimin e tyre përmes fuqizimit të ligjit;
- Përmes objektivit primar të nxitjes së praktikave të qëndrueshme të menaxhimit pyjor, Qeveria të mbështesë zbatimin e skemave të Çertifikimit të Pyjeve.

Gjuetia

Gjuetia e qëndrueshme nënkupton shfrytëzimin e llojeve të shtazëve dhe vendbanimeve në mënyrë që shkalla e humbjes afatgjatë të biodiverzitetit të jetë sa më e vogël. Kur gjuetia realizohet në mënyrë të qëndrueshme ndikimi në ruajtjen e popullacioneve të egra dhe vendbanimeve të tyre do të jetë pozitiv.
Kosova është regjion i pasur me lloje të faunës (Shihni kapitullin mbi llojet). Kësaj i kontribuojnë kushtet e mjedisit, pozita gjeografike dhe ruajtja relativisht e mirë e mjedisit. Në radhë të parë nën veprimin antropogjen, disa lloje shtazore janë në numër të vogël dhe trajtohen si lloje të kërcnuara. Mbrojtja e tyre është detyrë kryesore e të gjitha subjekteve që kujdesen për mjedisin ku ato kafshë jetojnë.
Duke i analizuar të dhënat mbi llojet dhe numrin e kafshëve të egra në Kosovë, mund të konstatohet se shumica e llojeve shtazore, janë në numër të ulët e disa janë në numër mesatar vetëm popullacioni i derrave të egër është i rritur kështu që do të nevojitet kohë e caktuar, që të plotësohen fondet e kafshëve të egra në kapacitetet optimale të mjediseve.
Në përgjithësi po punohet në hulumtimin e gjendjes reale të llojeve dhe numrit të kafshëve të egra, ku duhet sa më shpejtë qe është e mundur të bëhet monitorimi dhe inventarizimi i llojeve të kafshëve të egra. Vëmendje e posaçme duhet të kemi me llojet autoktone dhe të rralla e të kërcnuara siç janë: dhia e egër, rrëqebulli, ujku, ariu, pula e madhe e egër, shqiponja, etj.

Tabela. Vlerësimi i gjendjes dhe numrit të kafshëve të egra në Kosovë

Lloji i kafshëve të egra	*Vlerësimi i gjendjes 1-2-3*	*Vlerësimi i numrit*
Dreri (Cervus elaphus)	1	300 – 400
Drenusha (Dama dama)	(e rrethuar)	160
Kaprolli (Capreolus capreolus)	1 - 2	5.000 – 6.000
Dhe e egër (Rupicapra rupicapra)	1	400 – 500
Derri i egër (Sus strofa)	3	6.000 – 10.000
Ariu i murrëm (Ursus arctos)	1 - 2	80 – 100
Ujku (Canis lupus)	1 - 2	Deri në 100
Rrëqebulli (Lynx lynx)	1	20 – 25
Lepuri (Lepus europaeus)	1 - 2	5.000 – 10 000
Tetrao urogallus	1	?
Fazani i rëndomt (Phasianus sp.)	2	5.000 – 10 000

Fëllanxa e fushave (Perdix perdix)	1 – 2	5 000
Patat (Anatidae)	1	?
Llojet tjera të imëta	1 – 2	?

Vlerësimi i gjendjes: 1= Numër i vogël; 2= Gjendje e mirë; 3 = Gjendje shumë e mirë.

Kosova ka potenciale hapësinore dhe të mjediseve për kafshë për gjueti, prandaj edhe për caktimin e vend gjuetie dhe për menaxhimin e tyre. Nëse i përjashtojmë afro 200.000 ha, në të cilat ka vendbanime, rrugë dhe objekte, ku nuk është i mundur ushtrimi i gjuetisë, mbesin afro 900.000 ha mjedise për lloje të kafshëve dhe për kafshë për gjueti. Në territorin e Kosovës, gjenden katër vend gjueti të ndara si vend gjueti të interesit të posaçëm për Kosovë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 73.300 ha, që është afro 8% të sipërfaqes së përgjithshme, të përshtatshme për menaxhim të gjuetisë. Nga sipërfaqja për menaxhim të gjuetisë, duhet të përjashtohen 39.000 ha të Parkut Kombëtar "Mali Sharr". Zonat e mbrojtura të natyrës siç janë parqet kombëtare krijohen për ruajtjen e florës dhe faunës dhe nuk lejohet krijimi i vend gjuetisë në to.
Gjuetia mund të zhvillohet në vend gjuetinë e themeluar, për qëllime shkencore, turistike, sportive dhe ekonomike. Gjuetia rregullohet me Ligjin për gjuetinë dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë të tij si dhe planet menaxhuese 10 vjeçare.
Vend gjuetia mund të jetë: Vend gjueti private (nuk ka të krijuar asnjë të tillë), Vend gjueti e përbashkët (deri më tani janë krijuar 20 vend gjueti të përbashkëta); dhe vend gjueti me rendësi të veçantë (Blinaja dhe Duboqaku).

6.3.5. Problemet kryesore të identifikuara:

- Gjuetia ilegale, ekziston numër i madh i "gjuetarëve" të cilët nuk kanë njohuri elementare për rëndësinë e gjahut dhe shtazëve të egra;
- Nuk ka monitorim të mirëfilltë të llojeve të cilat ndodhen ne Anekset e Direktivës për zogjtë e egër dhe Direktivës për habitatet;
- Bashkëpunimi jo i mirë me gjykatat, policinë dhe institucionet tjera relevante;
- Mungesa e kuadrit profesional në lëmin e gjuetisë si dhe planeve të menaxhimit për gjitaret e mëdhenj (Ariu, Ujku, Dhia e egër, Rrëqebulli) .

6.3.6. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Zbatimi me efikas i Ligjit për Gjuetinë nga të gjitha palët dhe hartimi i planeve menaxhuese 10 vjeçare posaçërisht për egërsirat e mëdha të cilat janë të rrezikuara (Ariu, Ujku, Dhia e egër, Rrëqebulli);
- Hartimi i studimeve për llojet që janë prezentë në Kosovë dhe janë të listuar në Anekset e Direktivës për zogjtë e egër dhe Direktivës për habitatet;
- Harmonizimi i gjuetisë me kërkesat e mbrojtjes së natyrës.

Peshkataria

Kosova ka një potencial të konsiderueshëm të ujërave të ëmbla. Në shumicën e ujërave zhvillohet peshkimi rekreativ-sportiv pa ndonjë përfitim të madh ekonomik.
Gjendja e lumenjve nuk është e kënaqshme për arsye të ndotjes së mjedisit për rreth, si dhe dëmtimeve të mëdha në shtretërit e lumenjve si pasojë e nxjerrjes së rërës dhe ngritjes së pajisjeve për pastrim dhe përpunim të zallit përgjatë rrjedhës së lumenjve.

Zhvillimi i akua-kulturës në Kosovë daton që nga vitet e '60-ta. Sasia e prodhimit të peshkut në hurdhat e peshkut është minimale, rreth 300 ton/vit. Prodhimtaria e troftës në Kosovë konsumohet kryesisht në hoteleri kurse shumë pak ose nuk gjendet fare në treg e freskët. Prodhimi i Troftës vitet e fundit ka shënuar një ngritje të dukshme por kjo nuk mund të ketë ndikim të madh tek zogjtë e egër peshk ngrënës, sepse organizohen në basene artificiale e shumë pak në kushte natyrore.
Sipas analizave të bëra nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duke pasur parasysh prodhimtarinë vendore të peshkut në hurdhat ekzistuese si dhe importin e peshkut të freskët dhe të ngrirë, konsumi i mishit të peshkut është 0.8 kg/banor, krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjerë është nën çdo mesatare të konsumit.
Menaxhimi i fondit të peshqve nuk bazohet në ndonjë plan menaxhues të hartuar nga institucione hulumtuese shkencore.

6.3.7. Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesë e zbatimit të ligjit dhe rregullave të aplikueshme për peshkim;
- Varfërimi i lumenjve me peshk për shkak të ndotjes së lumenjve dhe liqeneve.

6.3.8. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Futja e kushteve të ruajtjes së biodiverzitetit në ligjet dhe dokumentet për lëmin e peshkatarisë;
- Përmirësimi i kontrollit dhe ndërprerja e peshkimit ilegal përmes një bashkëpunimi më të ngushtë mes MBPZHR-së dhe MMPH-së, Shoqatave të peshkatarëve, dhe OJQ-ve;
- Inventarizimi i stoqeve të popullacioneve të peshqve dhe
- Shfrytëzimi maksimal i hapësirës ujore me shfrytëzim sa më të mirë të ushqimit natyral dhe ruajtjes së llojeve të peshkut.

Turizmi

Turizmi i bazuar në natyrë mund të ofrojë mundësi të mëdha për zhvillim dhe është sektori i dytë më i rëndësishëm pas bujqësisë me ndikim në zhvillim. Shpesh turizmi konsiderohet si një alternativë e suksesshme karshi bujqësisë intensive, pylltarisë ose peshkatarisë.
Eko turizmi paraqet një shembull ku të hyrat e pronarëve privat varen shumë nga shëndeti i ekosistemeve rrethuese. Ndonjë herë bizneset nuk i kushtojnë rëndësi ruajtjes se biodiverzitetit por ka shembuj kur ruajtja e biodiverzitetit është ndërlidhur me rritjen e fitimit nga aktivitetet e turizmit.
Turizmi në Kosovë radhitet ndër degët e ekonomisë me zhvillim të hovshëm në dhjetëvjeçarin e fundit. Në analizat strukturore dhe projeksionet afatgjata, turizmi vlerësohet si një shfaqje tejet dinamike me rëndësi për zhvillim dhe promovimin e zonave të mbrojtura të natyrës veçanërisht parqeve kombëtare dhe vlerave të trashëgimisë natyrore.
Zhvillimi ekonomik është një ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës. Në përpjekjet për të realizuar një segment të Programit të Qeverisë, është parë si i nevojshëm hartimi i kësaj strategjie ku është pasqyruar gjendja e tanishme e bazës materiale të sektorit turistik dhe ndikimet e tij në biodiversitet. Mundësitë që ka Kosova për një produkt të qëndrueshëm dhe konkurrent turistik, problemet dhe vështirësitë që e shoqërojnë zhvillimin e turizmit, do të trajtohen në këtë material.

Zhvillimi i turizmit dhe kapaciteteve turistike, grumbullimi i një numri të madh të njerëzve në zonat e mbrojtura të natyrës shpesh i kërcënon ekosistemet e ndjeshme dhe vendbanimet e vlefshme natyrore e me ketë bimët dhe shtazët. Për ketë arsye duhet të bëhet një analizë detale lidhur me ndikimet e turizmit në këto zona si dhe në llojet konkrete të bimëve dhe shtazëve. Rritja e numrit të vizitorëve do të ketë ndikim të dëmshëm në biodiverzitetin e këtyre zonave.
Format e turizmit të qëndrueshëm dhe eko-turizmi paraqesin kornizën ideale për zhvillimin e turizmit në përgjithësi. Eko-turizmi ngërthen në vete të gjitha llojet e turizmit dhe për bazë e ka qëndrueshmërinë e turizmit si aktivitet i njeriut i cili ofron mundësi për realizimin e të hyrave gjatë gjithë vitit me ndikim minimal në mjedis. Edhe pse vendi ynë ka potenciale për zhvillimin e eko-turizmit gjithçka është në fazën fillestare.
Zhvillimi i turizmit do të rezultojë edhe me shtimin e numrit të vizitorëve në zonat e mbrojtura të natyrës si dhe monumentet natyrore por vendi ynë nuk i ka të zhvilluara kapacitetet dhe ofertën turistike dhe edukative për vizitoret (fletëpalosjet, hartat, shoqëruesit turistik).
Kosova vështruar në aspektin turistik është e ndarë në pesë rajone turistike:

- Rajoni qendror i Prishtinës;
- Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare;
- Rajoni turistik i Sharrit;
- Rajoni turistik i Anamoravës;
- Rajoni turistik i Mitrovicës.



Hartë turistike burimi Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë- Divizioni i turizmit
Bazuar në studimet e deritanishme në Republikën e Kosovës, ekzistojnë kushte shumë të mira për ngritje të qendrave turistike për turizmin dimëror-sportiv.
Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare dhe rajoni i Sharrit janë dy rajone që kanë mundësit më të mira për zhvillimin e këtij lloj turizmit.
Ne vijim janë të pasqyruara mundësitë e ngritjes së qendrave për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv për këto dy rajone turistike. Qendrat turistike në rajonin turistik të

Alpeve Shqiptare mund të ngritën me kapacitet të tërësishëm 129.000 vizitor në vit ndërsa rajoni turistik i Sharrit 113.000 vizitor në vit duke pas parasysh se këto dy rajone janë njëkohësisht edhe qendrat më të mëdha floristike dhe faunistike në Kosovë ndikimi i zhvillimit të turizmit në këto dy zona do të jetë negativ në ruajtjen e biodiversitetit. Kurse ana pozitive e krejt kësaj është se do të krijohen të hyra të cilat mund të orientohen në veprimtarit e mbrojtjes së natyrës si dhe për ndërtim të infrastrukturës, monitorim dhe hulumtime shkencore.

6.3.9. Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e strategjisë së zhvillimit të turizmit;
- Objekte turistike të ndërtuara pa i respektuar procedurat mjedisore dhe
- Infrastruktura turistike ende e paplotësuar.

6.3.10. Prioritetet – Veprimet strategjike:


- Promovimi i trashëgimisë natyrore dhe peizazheve si vlera unike;
- Zhvillimi i një strategjie për turizëm të qëndrueshëm dhe miqësor me natyrën që plotëson kërkesat për ruajtjen e biodiverzitetit;
- Vendosja e standardeve dhe kritereve për zhvillimin e eko-turizmit në zonat e mbrojtura dhe
- Gjatë planifikimit të ndërtimit të infrastrukturës turistike të aplikohen procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pranueshmerisë për natyrën.

6.4. Ujërat, transporti, minierat dhe energjia

Ujërat

Menaxhimi i mirë me ujërat mund të ketë ndikim të rëndësishëm në ruajtjen e biodiverzitetit. Rregullimi i shtretërve të lumenjve të degraduar nga nxjerrja e zhavorit si dhe nga ndotjet në përgjithësi paraqesin njërin nder problemet kryesore në Kosovë.
Kërkesat për ujë po shtohen çdo ditë e më shumë. Ky shtim i kërkesave të ujit lidhet direkt me shtimin demografik, kushtet e jetesës, kapacitetin industrial dhe nevojat bujqësore. Zhvillimi i mëtejmë ekonomik dhe rritja e standardit jetësor shton edhe kërkesën për ujë. Në këtë aspekt, është shumë e rëndësishme që uji të përdoret në mënyrë racionale dhe për të marrë masat e nevojshme për të arritur këtë.
Prandaj, kjo mbetet një çështje kyçe për zhvillimin ekonomik dhe social të shtetit si dhe për biodiversitetin i cili mund të përdoret si një indikator i cilësisë së ujit.
Kosova nuk ka master planin e ujërave por punohet me një plan me afat të skaduar.
Në bazë të hulumtimeve më të hershme dhe rezultateve laboratorike të bëra nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) mbi kualitetin e ujit në aspektin kimik dhe bakteriologjik, lumenjtë e Kosovës, në aspektin e cilësisë, u takojnë kategorive në vijim:
Pellgu i Drinit të Bardhë: Lumi Drini i Bardhë, me derdhjet (prurjet) e tija si: Ereniku, Lumi i Pejës, Lumi i Deçanit, Mirusha, Lumi i Rahovecit, Lumi i Klinës, Lumi i Prizrenit dhe derdhjet e tjera më të vogla, janë ujëra me kualitet të kategorisë së parë dhe dytë (para se të kalojnë në vendbanime), kurse pas daljes nga vendbanimet e mëdha (qyteteve) i takojnë kategorisë së tretë.
Pellgu i Lepencit: Lumi Lepenc, me derdhjet e tija nga Kaçaniku, Ferizaj, Shtërpca, Vitia, etj. i takojnë kategorisë së katërt të ujërave.

Pellgu i Ibrit: Lumi Ibri dhe Sitnica, me derdhjet e disa përroskave dhe derdhjeve të kanalizimeve të qyteteve, Prishtevkës, derdhjes së Graçankës, etj. ne Lumin Sitnica (dikur në vitet e tetëdhjeta ishte një lumë i vdekur, kurse tani deri në një shkallë është ripërtërirë, pas mbylljes së njësitit të Gazifikimit dhe Azotikut), i takon klasës me kualitet të tretë e të katërt.
Pellgu i Moravës së Binçës: Lumi "Morava e Binçës", me derdhjet e kanalizimeve e prurjeve të ndryshme, pas daljes nga vendbanimet e mëdha, i takon kategorisë së katërt të ujërave.
Kjo tregon se ujërat në Kosovë janë pjesërisht të ndotur dhe kjo rezulton me një biodiverzitet të varfër të lumenjve tonë.
Burimet e ujit në Kosovë janë të pamjaftueshme krahasuar në nevojën për ujë, me një shtrirje jo të barabartë në kohë dhe hapësirë, me çka paraqitet si faktorë kufizues për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës. Sipërfaqja topografike ujëmbledhëse e Kosovës është 11.645 km^2 prej të cilave 10.908 km^2 janë në territorin e Kosovës, ndërsa sipërfaqja prej 758 km^2, është jashtë territorit te vendit tonë. Kosova ndahet në katër pellgje ujëmbledhëse[4], të cilat shkarkojnë ujërat në të tri dete: Detin Adriatik (pellgu i Drinit të Bardhë), Detin e Zi (pellgu i Ibrit dhe Moravës së Binçës) dhe Detin Egje (pellgu i Lepencit)[1]. Pjesa më e madhe e lumenjve i takon pellgut të Detit të Zi 50.7% , Detit Adriatik 43.5% dhe Detit Egje 5.8%. Mesatarja vjetore e reshjeve sillet rreth 600 mm në ultësira dhe rreth 1400 mm në viset malore. Pjesa perëndimore vlerësohet të jetë më e pasur me ujëra nëntokësore, përderisa pjesa lindore është më e varfër. Ekziston një nevojë e madhe për më shumë studime në këtë aspekt.



Burimi:IPH Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+

[4] Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore bazuar në Direktivën Kornizë për Ujëra (DKU 2000/60EC)

Lumenjtë kryesor janë: Drini i Bardhë (122 km), Sitnica (90), Lumbardhi i Pejës (62), Morava e Binçës (60),Lepenci (53), Ereniku (51), Ibri(42), Lumbardhi i Prizrenit (31).
Ekzistojnë katër penda/diga në Kosovë me lartësi më të madhe se 40 metra, Gazivoda, Batllava, Radoniqi dhe Badovci.
Nga pendat ekzistuese në Kosovë, Gazivoda dhe Radoniqi janë penda të cilat kanë destinime të shumëfishta, ndërsa Graçanka, Përlepnica dhe Batllava shfrytëzohen vetëm për furnizim me ujë, derisa Livoçi është jashtë përdorimit pasi që tërë vëllimi i rezervuarit është i mbushur me aluvion.
Deri më tani shfrytëzimi i ujërave nëntokësorë bëhet përmes puseve të ujit, ose nëpërmjet burimeve të cilat në shumicën e rasteve ndodhen në zonat kodrinore-malore.
Ende ka pak informacione lidhur me kapacitetin ekzistues dhe atë nxjerrës pasi nuk janë bërë studime përveç atyre në lidhje me monitorimin e pasqyrës së ujërave nëntokësorë.
Sipas të dhënave të fundit, vetëm 31% e popullsisë është e kyçur në rrjetin e kanalizimit.
Rrjeti i kanalizimit vende-vende është i ndarë ndërsa vende-vende i përzier (ujërat e ndotura dhe ujërat e bardha).
Ujërat e ndotura shkarkohen në mjedis pa u trajtuar. Pra, nuk kemi pajisje (impiant) për trajtimin e ujërave të ndotura.
Shumica e lumenjve janë të ndotur përtej mase kështu që biodiverzitetit në lumenj është shumë i ultë.
Erozioni dhe rrëketë në territorin e Kosovës rrezikojnë natyrën dhe pasuritë publike dhe private të krijuara dhe të planifikuara nga njerëzimi. Kjo manifestohet përmes degradimit të tokës bujqësore dhe pyjore, rrjetit rrugor dhe hekurudhor, si dhe objekteve ndërtimore dhe vendbanimeve. Vlerësimi i gjendjes së erozionit është paraqitur në detaje në një hartë për tërë territorin e Kosovës.
Sipas të dhënave që disponojmë gjendja e ekzistuese e erozionit është:
Kategoria I, II, III - 5.973 km² ose 55.6 %
Kategoria (erozion i dobët) IV - 3.680 km² ose 34.2 %
Kategoria (erozion shumë i dobët) V - 1.097 km² ose 10.2 %.
Kurse sa i përket ligatinave Kosova nuk është e njohur për këto lloje të tokave sepse ka sipërfaqe të papërfillshme me ligatina.
Aktivitetet si shfrytëzimi i zhavorrit, rregullimi i shtretërve te lumenjve mandej sistemeve të ujësjellësve mund të kenë ndikim negativ në biodiverzitet përmes shkatërrimit të vendbanimeve natyrore dhe peizazheve.
Gjatë planifikimit të aktiviteteve në infrastrukturën ujore duhet të merren në konsideratë procedurat e VNM dhe pranushmerisë së veprimit për natyrën.
Problem për biodiverzitetin në Kosovë paraqesin ujërat e ndotura nga kanalizimet urbane si dhe ndotja industriale nga e kaluara. Njëkohësisht ndotja e ujit nga përdorimi i plehrave minerale dhe pesticideve në bujqësi mund të jetë problem me ndikim në ruajtjen e biodiverzitetit.

6.4.1. Problemet kryesore të identifikuara:

- Ka humbje të biodiverzitetit të florës dhe faunës ujore si shkak i ndotjes së ujërave nga ndotja urbane, bujqësia dhe industria;
- Sasi e pamjaftueshme e ujit, veçanërisht gjatë periudhave të thata;
- Siguria e pendave është një problem potencial me efekte të rëndësishme në biodiversitet dhe
- Ndërtimet për nevoja të prodhimit të hidro-energjisë si dhe nxjerrja e zhavorrit paraqesin kërcënim për biodiversitetin ujor.

6.4.2. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujit dhe kontrolli i rrjedhës së lumenjve duke përdor treguesit e rimëkëmbjes së biodiversitetit;
- Të pengohet shkatërrimi i ekosistemeve lumore nga shfrytëzimi i zhavorrit dhe degradimi i shtretërve të lumenjve si dhe të përmirsohet menaxhimi i pellgjeve lumore;
- Sigurimi i ujit përmes një strategjie të përshtatshme duke përfshirë sigurimin e digave dhe rrjetit të ujësjellësve në mënyrë të tillë që përfitimet të jenë sa më të mëdha për biodiversitetit;
- Të shtohet bashkëpunimi ndërmjet inspektorateve të ujërave dhe të natyrës në zbatimin e kushteve për mbrojtjen e natyrës;
- Zbatimi i procedurave mjedisore VSM dhe VNM e posaçërisht kur aktivitetet planifikohen të ndërmerren në zonat ujore dhe ligatina.

Transporti

Brenda territorit të Republikës së Kosovës kemi mbi 2000 km rrugë të rendit magjistral dhe rajonal, gjithashtu kemi mbi 5000 km rrugë të rendit lokal. Kjo infrastrukturë rrugore vlerësohet si pjesërisht e dëmtuar, joadekuate dhe si e pamjaftueshme karshi kërkesave. Ndërtimi i rrugëve të reja e veçanërisht auto udha do të ketë ndikim negativ në fragmentimin e vendbanimeve natyrore dhe uljen e cilësisë së tyre për shkak të zhurmës dhe dritës. Një numër i konsiderueshëm i shtazëve të egra akcidentohen nga komunikacioni me çka vjen deri te humbja e biodiverzitetit. Vitet e fundit në Kosovë janë ndërtuar një numër i madh i rrugëve dhe si pasojë është shtuar rreziku për shtazët e egra.
Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit (MTPT) përgjegjëse për komunikacionin në vend synon të krijojë një sistem të integruar të transportit për të gjithë kosovarët duke ju mundësuar atyre të zgjedhin transportin e tyre efikas që i përmbushë kërkesat e tyre, si dhe çështjeve mjedisore nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me sektorët tjerë.
Planet për transportin paraqesin bazën e përzgjedhjes dhe zhvillimit të projekteve të transportit. Sidoqoftë, për shkak të kornizave të tyre afatgjata dhe shkallës së gjerë, këto plane shpeshherë zhvillohen pa ndonjë shqyrtim të detajuar lidhur me ndikimin e zbatimit të tij në mjedis dhe natyrë. Kjo krijon probleme të rënda në realizimin e disa projekteve të rëndësishme, nëse jo pamundësimin e tyre për shkak të pasojave mjedisore që mund të identifikohen. Gjithashtu, mos marrja në shqyrtim e faktorëve mjedisor gjatë planifikimit të transportit mund të ndikojë tek vendimmarrësit që të lënë anash mundësitë për miratimin e planeve që janë plotësisht në përputhje me synimet shtetërore dhe rajonale mjedisore si dhe për zbatimin e lehtësirave dhe përmirësimeve të mëdha në këtë fushë.
Mbrojtja e mjedisit tani është njeri prej synimeve të MTPT-së dhe zbatimi i ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Ligjit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) kërkojnë hartimin e një raporti të vlerësimit për të gjitha projektet e reja duke pasur për qëllim harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenien shoqërore me parimet bazë për mbrojtje të mjedisit përfshirë këtu edhe aspektet e biodiversitetit_sipas konceptit për zhvillim të qëndrueshëm.
Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet sidomos zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë me rëndësi për ruajtjen e biodiverzitetit, ekosistemeve, specieve, varieteteve gjenetike dhe rrjetit ekologjik.

6.4.3. Problemet kryesore të identifikuara:

- Humbja ose fragmentimi i vendbanimeve natyrore me rezultat degradimin e cilësisë së vendbanimeve (në Kosovë nuk ka asnjë mbikalim për kafshët e egra);
- Shkatërrimet e peizazhit nga ndërtimi i rrugëve pa përmbushjen e standardeve mjedisore (pa raporte të VSM dhe VNM);
- Mungesa e sinjalizimit adekuat lidhur me vendkalimet e njohura për shtazët e egra.

6.4.4. Prioritetet – veprimet strategjike:

- Ndërtimi i rrugëve me standarde të larta duke respektuar procedurat mjedisore;
- Të ndërtohen mbikalimet për shtazët e egra aty ku nevojitet vazhdimësia e vendbanimit natyror.

Minierat

Kosova është një vend me pasuri të konsiderueshme në minerale dhe kjo paraqet një presion tjetër për ruajtjen e biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore. Në Kosovë më së shumti ka minerale nga të cilat prodhohet energjia elektrike (linjit) ndërsa ka edhe sasi të konsiderueshme të mineraleve nga të cilat fitohen metalet si Nikeli, Zinku, Plumbi, Ari, Argjendi, Kromi etj.
Pastaj mineralet qe përdoren në ndërtimtari gurët gëlqeror, zalli i lumenjve, deltina etj. që shfrytëzimi i tyre paraqet presion në biodiverzitet dhe larmin peizazhore.
Si rezultat i eksploatimit të mëhershëm të mineraleve shumë miniera të shterura kanë mbetur pa u ri kultivuar dhe njëkohësisht kanë ndikim të dukshëm në peizazhe, këso veprimesh ka edhe në brendi të territorit të zonave të mbrojtura. Aktivitetet minerare kanë ndikim të madh në biodiverzitet, të cilat shkaktojnë ndotjen dhe shkatërrimin e vendbanimeve natyrore.Gjerë me tani janë zhvilluar disa projekte:

- ↳ Projekti i spastrimit dhe ri kultivimit të tokës në KEK-u,. është një projekt madhor i financuar nga BB-re dhe Qeveria e Kosovës;
- ↳ Rehabilitimi i deponive të mbetjeve industriale në minierën e Plumb – Zinkut në Artanë;
- ↳ Rehabilitimi i deponive të mbetjeve industriale nga miniera e Plumb – Zinkut në Trepçë në fshatin Kelmend; dhe
- ↳ Pilot projekti që është duke u zhvilluar për mbushjen e punimeve minerare (puseve) të pashfrytëzuara në minierën e Plumb – Zinkut në Trepçë lënda mbushëse- ,,hiri''i KEK-ut.

6.4.5. Problemet kryesore të identifikuara:

- Degradimi i vendbanimeve natyrore nga një numër shumë i madh i ndërhyrjeve ilegale gurthyesi në Rusenicë (Rezervat shtazor,i rrëqebullit - Lynx lynx L.);
- Minierat e shterura të cilat kanë mbetur pa u rikultivuar dhe paraqesin rrezik të përherëshem si për erozion ashtu edhe për shtazët e egra;
- Mungesë e mjeteve financiare për ri kultivimin e minierave të shterura dhe të braktisura.

6.4.6. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Të sigurohet kadastra e të gjitha minierave (legale dhe ilegale) në territorin e zonave të mbrojtura;
- Të shtohet bashkëpunimi i inspektorateve të xehetarisë dhe atyre të mbrojtjes së natyrës si dhe ndërmjet niveleve (lokal dhe qendror);
- Përcaktimi i kushteve për mbrojtjen e natyrës në Planet për ekonomizim me resurset natyrore dhe
- Mbështetja e pilot projekteve për rikultivimin e minierave të shterura në përgjithësi si dhe brenda zonave të mbrojtura në veçanti..

Energjia

Energjetika paraqet njërin nder sektorët i cili ka ndikim të dukshëm në ruajtjen e biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore. Prodhimi i tanishëm kryesisht bazohet në termocentrale (97%), shumë pak nga hidrocentralet (3%) ndërsa nga burimet tjera alternative prodhohet një sasi e vogël që në krahasim me sasinë e përgjithshme të energjisë elektrike për momentin mund të konsiderohet e papërfillshme. Bazuar në Strategjinë e sektorit të energjisë do të ngritën edhe kapacitete të cilat do të shfrytëzojnë burimet e ripërtërishme si uji, dielli, era dhe biomasa. Gjithashtu është shumë i rëndësishëm synimi që energjia të kursehet dhe përdoret me efiçiencë duke zhvilluar sisteme të cilat kursejnë energjinë. Duhet pas parasysh qe ndikimet negative gjatë ndërtimit të objekteve si dhe gjatë operimit të minimizohen duke respektuar procedurat e Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis si dhe plotësimin e standardeve mjedisore bazuar në legjislacionin vendor. Historikisht, energjia dhe minierat kanë qenë shtyllat e ekonomisë kosovare, duke ofruar punësim dhe gjenerim i të ardhurave, fitim nga eksporti dhe kontribute për industritë e tjera. Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë sot varet nga Termocentralet Kosova "A" dhe "B", të cilat përdorin linjitin. Janë kryer disa studime në lidhje me efektet negative mjedisore nga mihjet sipërfaqësore të linjitit si dhe nga Termocentralet Kosova A dhe B.
Një studimi bërë me 11-15 prill 2007 qe shtjellon problemin e faunës dhe florës në zonën e mihjeve dhe të Termocentraleve, është identifikuar flora dhe fauna, si dhe shumica e llojeve të bimëve (drunjte, shkurret dhe bimët barishtore).
Është treguar se biotopet kanë llojllojshmëri të larte të florës dhe faunës, i cili karakterizohet nga lloje të mbrojtura dhe të kërcënuara në nivel kombëtar siç është Lejleku, Ciconia ciconia, Anas querquerdula, Tringa totanus dhe probabilitet te llojit të veçante të rrezikuar Crex crex dhe Ixobrychus minutes të listuar në Shtojcën I të Direktivës se BE-se mbi zogjtë e egër si lloje të kërcënuara por nuk janë endemike, të tre llojet gjenden në Evropë, në pjesë të Azisë dhe gjetiu.
Shumica e lokacioneve ku janë kryer studimet rezultojnë me ndikim nga aktivitetet e njeriut.
Në afërsi të fshatrave është gjetur edhe vegjetacioni i egër. Biotopet natyrore janë gjetur në afërsi të lumit Sitnica dhe përfshijnë tokat e lagështa ndërmjet Bivolakut dhe Prilluzhes, pyjet me shelgje rreth lumit Sitnica, biotopet tjera natyrore përfshijnë zona me shkurre rreth Bivolakut dhe pyje me lisa në anën perëndimore të Bivolakut.
Strategjia e Energjisë për Kosovën 2009 – 2018 (SEK) parasheh hapjen e Fushës së Re të Mihjes në Siboc, në fillim pjesa jugperëndimore e saj si dhe ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re.Minierat kryesore të linjitit janë në Mirash dhe Bardh si dhe miniera e re Jugperëndimore Siboc. Një sipërfaqe e konsiderueshme është e zënë nga ish Industria kimike „Gazifikimi"dhe miniera e rihapur 2008 - 2009 e Sitnicës.

Strategjia e Energjisë së Kosovës 2009 - 2018 parasheh edhe prodhimin e energjisë elektrike dhe termike nga burimet ripërtërishme të energjisë (uji, era,dielli) dhe parasheh edhe kyçje të Kosovës në rrjetin rajonal të gazit
Strategjia njëkohësisht promovon efiçiencen e energjisë në gjithë sistemin energjetik, nga gjenerimi gjer tek konsumatori.
Realizimi i këtyre projekteve të mëdha në sektorin energjetik në të ardhmen e afërt do të rezultojë me zënien e sipërfaqeve të shumta tokësore me çka do të vije gjer te degradimi i sipërfaqes, humbja e biodiverzitetit.. Vetëm Miniera e linjitit Siboci jugperëndimor dhe TC – Kosova e Re do të zënë një sipërfaqe diku afër 800 hektar shtesë deri ne vitin 2033, ne krahasim me sipërfaqen zënë sot afër 2.900 hektar. Për shkak të deficitit të madh që do të shkaktohet nga nxjerrja e djerrinës dhe linjitit do të mbetet një grope e madhe prej rreth 500 hektarëve në pjesën veriore të fushës së Sibocit, e cila në këndvështrim afat gjatë (40-50 vite) do të mund të krijohet një liqen atraktiv, rekreativ, e përshkruar me një brez të gjelbër për rreth.
Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) përkrah zhvillimin e sektorit të energjisë duke promovuar edhe prodhimin energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë bazuar edhe ne kërkesat dhe detyrimet që ka ky sektor karshi Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) - Aqcuis mbi Mjedisin, Aqcuis mbi Burimet e Ripërtërishme të Energjisë.
Në Kosovë ka përfunduar studimi i fizibilitetit mbi kapacitetet e mundshme hidropotenciale në Kosovë i cili për momentin ka identifikuar 18 lokacione për prodhimin e energjisë elektrike nga hidro - centralet me kapacitet të vogël të prodhimit (më të vogla se 10 MW). Ky studim përshkruan edhe efektet që mund të kenë këto hidropotenciale të vogla në mjedis e veçanërisht për biodiverzitetitn. Në krahasim me Termocentralet ndikimi i këtyre hidropotencialeve do të jetë dukshëm më i vogël ose fare i pa rëndësishëm për mjedisin – biodivesritetin. Mënyra e gjenerimit të energjisë elektrike nga këto hidropotenciale nuk do të jetë përmes krijimit të liqeneve akumuluese por do të jetë e tipit të kanaleve rrjedhëse, gjë që dukshëm zvogëlon ndikimin në mjedis.
Gjithashtu ka përfunduar studimi i financuar nga Banka Botërore (BB) për Hidrocentralin (HC) - Zhuri, me fuqi pre 305 MW dhe prodhim mesatar vjetor prej 397,59 GWH. Hidropotencialet e reja të tipit të këtillë me kapacitet të lartë dhe me ujë akumulues sigurisht se do të kenë edhe efektet e tyre në mjedis, duke zënë sipërfaqe të konsiderueshme të tokave pjellore, sipërfaqeve pyjore, duke bërë rrezikimin e florës dhe faunës në këto zona.

6.4.7. Problemet kryesore të identifikuara:

- Ndotja e tokës nga e kaluara, zënja e siperfaqeve të mëdha me deponi e djerrina dhe ndotja e ujërave nga industria kanë qenë dhe mbeten burim i përhershëm i ndotjes së mjedisit;
- Peizazhi shumë i shkatërruar me degradime të mëdha të sipërfaqes nga deponit e hirit dhe objektet përcjellëse industriale;
- Prodhimi i energjisë për momentin kryesisht i bazuar në burime të linjitit krijon presion në burimet e ripërtërishme për të arrit standardet e kërkuara për llojshmërinë e energjisë.

6.4.8. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Për projekte zhvillimore të sektorit të energjisë të aplikohen procedurat e VSM dhe VNM;

- Të vendosen kushtet dhe masat për mbrojtjen e natyrës gjatë nxjerrjes se planeve hapësinore për potencialet e reja energjetike;
- Tek caktimi i lokacionit të Centraleve me erë tu iket zonave të rëndësishme të zogjve dhe korridoreve të tyre të migrimit;
- Gjatë ndërtimit të largpërçuesve të bëhen zgjidhje teknike të cilat e zvogëlojnë në minimum ngordhjen e zogjve nga goditja e rrymës.

6.5. Planifikimi Hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Planifikimi hapësinor

Ligji për planifikim hapësinor (nr.2003/14) shpallur me rregulloren nr. 2003/30 dhe Ligji nr. 03/L-106/2008 për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, parasheh rregullimin dhe planifikimin hapësinor në tërë teritorin e Republikës së Kosovës, me qëllim të harmonizimit të të gjithë sektorëve dhe promovimin e zhvilllimit të qëndrueshëm si dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit sipas standardeve europiane.
Në Republikën e Kosovës janë dy nivele të planifikimit: Planifikimi për territorin e Kosovës dhe Planifikimi për teritorin e komunave:

- ↳ Niveli qëndror: Plani Hapësinor i Kosovës, Plani hapësinor për zona të veçanta.
- ↳ Niveli lokal: Plani Zhvillimor i Komunës, Plani Zhvillimor Urban, Plani Rregullues Urban.

Plani Hapësinor i Kosovës përcakton parimet dhe qëllimet afatgjata të planifikimit hapësinor për teritorin e Kosovës për një periudhë më së paku dhjetë vjeçare dhe bazohet në vizionin, caqet strategjike, parimet ndërkombëtare të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
Ligji për planifikim hapësinor dhe ligji për mbrojtjen e natyrës sigurojnë kondita për zhvillimin e planeve hapësinore për zonat e veqanta.
Planet hapësinore për zonat e veçanta miratohen për zonat me katakteristika të veçanta natyrore të identifikuara në Planin Hapësinor të Kosovës të cilat kërkojnë regjim të veqant të mbrojtjes, ruajtjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit të tyre. Këtu përfshihen: parqet kombëtare, si dhe zonat me vlera të veçanta natyrore, kulturo – historike, ekonomike etj.
Plani hapësinor për Parkun Kombëtar "Mali Sharr" parasheh strategjinë me të cilën arrihen synimet dhe objektivat për parkun që konsiston në mbrojtjen dhe ruajtjen e të gjitha elementeve mjedisore (ajrit, ujit dhe tokës), biodiversitetit, peizazheve dhe vlerave tjera të natyrës e pastaj shfrytëzimin racional të tyre për shkaqe të hulumtimit shkencor, rekreacionit, turizmit.
Meqenëse me tepër se kurr paraqitet nevoja për të mbrojtur natyren, biodiversitetin, llojet e rrezikuara dhe habitatet e tyre, planet hapesinore janë të orientuara për të mbrojtur mjedisin mbrenda zonave që duhet të ruhen duke u përqëndruar kryesisht në: infrastrukturë, turizem, ndërtim dhe zhvillim ekonomik.
Organizimi i hapësirës dhe mënyra e planifikimit dhe rregullimit të hapësirës në zonat e mbrojtura behet përmes Planeve hapësinore të zonave me destinime të veçanta. Është hartuar Draft plani hapësinor për Parkun kombëtar Mali Sharr. Sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e natyrës menaxhimi me rezervatin strikt të natyrës, parkun kombëtar, zonën e veçantë si dhe parkun e natyrës bëhet përmes planit menaxhues i cili nxirret për periudhë prej dhjet vitesh. Deri me sot nuk ka asnjë plan hapësinor e as plan menaxhues të aprovuar për menaxhim me zonat e mbrojtura.
Planet hapësinore të nivelit lokal, planet hapësinore për zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të mbrojtura duhet të jenë të harmonizuara me Planin hapësinor të Kosovës.

6.5.1. Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesë e planeve hapësinore për zonat e mbrojtura

6.5.2. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Të nxirren planet hapësinore për zonat e mbrojtura të natyrës, fillimisht parqet kombëtare më vonë për zonat tjera të mbrojtura;
- Vendosja e sistemit të kontrollit dhe integrimi i kushteve dhe masave të ruajtjes së natyrës (biodiverzitetit dhe larmisë pejzazhore) në politikat e planifikimit hapësinor;

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Në Kosovë zbatohen procedurat e vleresimit te ndikimit ne mjedis sipas Ligjit të VNM nr.03/L – 024. Qëllimi i këtij ligji është që të bëjë parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis të projekteve të propozuara nga operatori.
Ky Ligj përcakton procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që gjatë marrjes së vendimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor të sigurohen të gjitha informatat relevante për ndikimet që projekti do ti ketë në mjedis dhe biodiverzitet.
Shumë veprimtari kryhen pa pëlqim mjedisor dhe licencë valide dhe në këtë menyrë shkaktojnë dëmtime në shtretërit e lumenjve, mandej shkatërrojnë peizazhin si dhe biodiverzitetin.
Gjithsejtë operator që merren me biznesin e gurthyesve dhe përpunimin e gurit janë 463 prej tyre 265 janë ilegal kurse më pak se gjysma ose 198 janë të pajisur me pëlqim mjedisor.
Eksploatimin e gurit gëlqeror, rërës dhe zhavorrit e bëjnë 150 kompani të pajisura me Liçenca kurse pa to 65 kompani.
Këto kompani bëjnë presion në ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore përmes degradimeve të ekosistemeve të lumenjve dhe ekosistemeve pyjore.

6.5.3. Problemet kryesore të identifikuara:

- Shumë kompani ushtrojnë bizneset pa pëlqime dhe leje mjedisore;
- Minierat e shterura janë braktisur pa kryer ri kultivimin e tyre.

6.5.4. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Fuqizimi i ligjit, bashkëpunimi ndërmjet niveleve të qeverisjes;
- Vendosja dhe zbatimi i një sistemi për VNM dhe VSM

6.6. Korniza ligjore dhe institucionale

Korniza ligjore

Mbrojtja dhe ruajtja e të gjitha vlerave të natyrës dhe biodiverzitetit është përgjegjësi e secilit bazuar në Nemin 52 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, ndërsa kornizën

ligjore për mbrojtjen e biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore e përben Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233 GZRK Nr.85/09.11.2010 dhe aktet nënligjore të nxjerrura prej tij.
Ky ligj përcakton sistemin për mbrojtjen e natyrës, vlerat e natyrës të përcaktuara në pajtim me këtë ligj janë me interes për Kosovën dhe gëzojnë mbrojtje të posaçme.
Ky ligj krijon bazën ligjore për mbrojtjen e natyrës, zhvillimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht:

- mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim,
- monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;
- pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;
- sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së;
- ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të gjithë personave juridik, fizik dhe asociacionet të cilat janë bartës të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga legjislacioni vendor dhe aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.
Ligji për mbrojtjen e natyrës vazhdimisht harmonizohet me direktivat relevante për natyrën dhe Acquisin mjedisor e posaçërisht me Direktivën e Vendbanimeve natyrore 92/43 EEC, Direktiva e zogjve të egër 79/409 EEC, Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES).
Në përgjithësi legjislacioni në fuqi ofron një bazë të qëndrueshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe biodioversitetit të Kosovës, por ky legjislacion duhet të zbatohet në mënyrë të efektshme.
Kosova ende nuk është nënshkruese e Konventave dhe traktateve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës përveç Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë ku Kosova obligohet të ndërmarr veprimet lidhur me zbatimin e Nenit 4 pika 2 të Direktivës për zogjtë e egër.
Janë ndërmarr hapa fillestar në identifikimin e zonave potenciale për Rrjetin ekologjik NATURA 2000 në Kosovë.
Disa nga ligjet ekzistuese janë në harmoni me Ligjin për mbrojtjen e natyrës njëkohësisht po punohet në harmonizimin e legjislacionit ndërmjet sektorëve si (pylltaria, bujqësia, gjuetia, veterina, ujërat, mbrojtja e mjedisit etj.) me parimet e Konventës së biodiverzitetit dhe kërkesat e Acquisit për mjedis të BE.

Në të kaluarën që nga viti 1953 në Kosovë ka filluar të tregohet një interesim për vlerat e trashëgimisë natyrore me shpalljen e tyre të mbrojtura si p.sh. Rezervati strikt bimor i Bozhurit (Paenonia decora Anders) mandej 1955 Rezervati shtazor i llojit dhia e egër (Rupicapra rupicapra L.), Rezervat shtazor,i rrëqebullit (Lynx lynx L.) etj . Këto zona janë shpallur në bazë të legjislacionit të asaj kohe dhe vendimeve të niveleve të ndryshme të vendimmarrjes.

Ligjet të cilët rregullojnë ruajtjen e natyres dhe mjedisit

Nr.	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Data e miratimit	Akti dhe data e publikimit
1.	Ligji për mbrojtjen e natyres	03/L-233	30.09.2010	DL-054-2010 18.10.2010 GZK nr. 85 09.11.2010
2.	Ligji për PN "Mali Sharr"	GZK -11/86	28.03.1986	GZK 11/86
3.	Ligji për mbrojtjen e mjedisit	03/L –025	26.02.2009	DL – 007/2009 19.03.2009 GZK nr.50, 06.04.2009
4.	Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Nr. 03/L-160	25 02. 2010	DL-012-2010, 12.03.2010 GZK nr.67, 29.03.2010
5.	Ligji për ujërat	2004/24	08.07.2004	2004/41 14.10.2004 GZK nr.18 01.11.2007
6.	Ligji për Planifikimin Hapësinor Nryshimet dhe plotësimet	2003/14 03/L-106	03.07.2003 10.11.2008	2003/30 GZK nr17, 01.102007 DL-055-2008, 17.11.2008 GZKnr.42 25.11.2008
7.	Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor	03/L-230	30.09.2010	DL-050 -2010, 18.10.2010 GZK nr.83 2910.2010
8.	Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis	03/L214	23.09.2010	DL-048 -2010, 14.10.2010 GZK nr.83, 29.10.2010
9.	Ligji për mbeturina	02/L – 30	22.07.2005	2006/31, 05.05.2006 GZK nr.23, 01.04.2008
10.	Ligji për veprimtarinë hidrometorologjike	02/L – 79	15.06.2006	2007/2, 09.01.2007 GZK nr. 25, 01.06.2008
11.	Ligji për mbrojtjen nga zhurma	02/L – 102	30.03.2007	2008/15 17.03.2008 GZK nr.40 15.10.2008
12.	Ligj për kimikate	02/L116	27.04.2007	2008/8 08.02.2008 GZK nr.35, 15.08.2008
13.	Ligji pë produktet biocide	03/L-119	27.05.2009	DL-014-2009, 10.07.2009, nr.55)10.07.2009

Ligjet e sektorëve tjerë me ndikim në ruajtjen e biodiverzitetit

Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit	Dt. e miratimit	Akti dhe data e publikimit
Ligji për pyjet e Kosovës Ndryshimet dhe plotesimet	2003/3 2004/29	13.02.2003 28.07.2004	2003/6 20.03.2003 GZK nr.34, 01.08.2008 2004/40, 14.01.2004 GZK nr.34, 01.08.2008
Ligji për tokat bujqësore	02/L – 26	24.06.2005	2006/37 23.06.2006, GZK nr.13 01.06.2007
Ligji për farërat	2003/5	20.03.2003	2003/10 15.04.2003
Ligji për plehrat artificiale	2003/10	22.05.2003	2003/22 23.06.2003, (GZK nr.16), 01.09.2007
Ligji për rrugët Ndrysh.dhe plotësimet	2003/11 03/L-120	29.05.2003 16.12.2008	2003/24 27.06.2003, GZK nr.16, 01.09.2007 2008/075, 30.12.2008, GZK nr.46, 15.01.2009
Ligji për Energjinë	2004/8	29.04.2004	2004/21 30.06.2004, GZK nr.22, 01.03.2008
Ligji për materialin fidanor	2004/13	29.04.2004	2004/16, 28.05.2004, GZK nr.22, 01.03.2008
Ligji për Veterinarinë	2004/21	16.06.2004	2004/28 30.07.2004
Ligji për blegtorinë e Kosoves	2004/33	08.09.2004	2004/39 14.10.2004 GZK nr.18, 01.11.2007
Ligji për ujitjen e tokave bujqësore	2005/02/L - 9	23.03.2005	2005/49 25.11.2005, GZK nr.11, 0104.2007
Ligji për kujdesin ndaj kafshëve	02/L - 10	23.03.2005	2005/24, 09.05.2005 GZK nr.5, 01.10.2006
Ligji për gjuetinë	02/L - 53	16.12.2005	2006/41, 11.08.2006, GZK nr.8, 01.01.2008

Ligji për mbrojtjen nga zjarri	02/L - 41	06.04.2006	2006/57 20.12.2006, GZK nr.23, 01.04.2008)
Ligji për mbrojtjen nga fatkeqit natyrore dhe fatkeqësitë tjera	02/L - 68	01.06.2006	2007/4, 15.01.2007, GZK nr.24, 01.05.2008
Ligji për peshkatari dhe Akuakulturë	02/L - 85	10.10.2006	2006/58, 20.12.2006, GZK nr.24, 01.05.2008
Ligji për mbrojtjen e bimëve	02/L - 95	22.12.2006	2007/6, 31.01.2007 GZK nr.29, 01.07.2008
Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve	02/L - 98	26.01.2007	2008/24 16.05.2008, GZK nr.40, 15.10.2008
Ligji për bletari	02/L - 111	30.03.2007	2008/5 08.02.2008 GZK nr.15, .08.2008
Ligji për Bujqësinë organike	02/L - 122	17.09.2007	2008/2, 08.01.2008, GZK nr.37, 10.09.2008
Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve	03/L – 042	07.11.2008	2008/061 27.11.2008 GZK nr.44 22.12.2008
Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës Ndryshim dhe Plotësimet	2003/25 2004/19 03/l – 002	06.07.2003 6.06.20014 06.11.2008	2003/25 dt.06.07.2003 2004/19, 16.06.2004 2008/059,27.11.2008 GZK nr.44, 22.12.2008

Veprat kriminale që kanë të bëjnë me biodiverzitetin janë sanksionuar me Kodin Penal të Kosovës kapitullin XXIV: VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE - Neni 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282,283, 284, 285, 286, 287 dhe 288.
Fuqizimi i shumicës së këtyre ligjeve relevante për biodiverzitetin është i dobët posaçërisht për shkak të mungesës së njohurive dhe mbështetjes për zbatimin e legjislacionit i cili shpesh është i paqartë, kundërthënës dhe jo komplet.
Gjatë konsultave me komunitetet e ndryshme dhe palët kyçe të përfshira u konstatua se disa pjesë të legjislacionit janë jo adekuate dhe kërkojnë rishikim për një zbatim më efektiv. Një bashkëpunim më i mirë ndërmjet institucioneve dhe agjencive është i domosdoshëm me qellim të ruajtjes së biodiverzitetit.

Marrëveshjet dhe traktatet

Konventat, Direktivat dhe Rregulloret relevante për ruajtjen e natyrës janë: Konventa për Biodiverzitetin, Direktiva e KE për habitatet natyrore, Direktiva e KE për zogjtë e egër, Direktiva Kornizë e Ujërave, Konventa e peizazheve të Evropës, Konventa e Alpeve, Konventa Karpateve, Konventa e Bonit, Konventa Ramsar, UNESCO Mab Programme (The Man and the Biosphere), Rregullorja CITES etj.
Direktiva e zogjve dhe habitateve kanë potencë të bëhen veglat me efikase të ruajtjes së biodiverzitetit në Evropë, duke krijuar një kornizë për mirëmbajtjen ose arritjen e një statusi të mirë të ruajtjes për zonat mbrojtura të rrjetit "Natura 2000".

Kosova gjer më tani ka nënshkruar:

- Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm me Republikën e Shqipërisë, Prishtinë 04.07.2008;
- Traktatin mbi themelimin e Komunitetit të Energjisë 25.10.2005
- PVPE për bashkëpunim me Këshillin e Evropës ka të miratuar Planin e Veprimit për Partneritet Evropian 2009 - 2011.

- ↳ Memorandum bashkëpunimi në mes MMPH - së dhe Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore të Kosovës, 05.06.2008.
- ↳ Rezolutën për zhvillimin e qendrueshëm të Regjionit të Harkut Dinarik, 09.03.2011

6.6.1. Problemet kryesore të identifikuara:

- Zbatimi i ligjeve është i dobët gjë që krijon një shqetësim dhe trysni në fushën e mbrojtjes së natyrës;
- Mungon harmonizimi i ligjeve ndërmjet sektorëve.
- Konventat dhe protokollet ende nuk janë nënshkruar.

6.6.2. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Të plotësohet dhe harmonizohet legjislacioni vendor ndër sektorial në mënyrë që të sigurohet zbatimi i efektshëm i Konventës mbi biodiverzitetin dhe Direktivat relevante të BE – së;
- Të ratifikohen konventat ndërkombëtare më të rëndësishme nga lëmi i ruajtjes se larmisë biologjike dhe peizazhore si dhe nënshkruhen protokollet;
- Nxjerrja e ligjeve të veçanta për zbatimin e Konventave ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së larmisë biologjike dhe peizazhore dhe
- Të nxirren dispozitat mbi mekanizmat financiar për mbrojtjen e natyrës – Eko fondi.

Korniza Institucionale

Organi më i lartë legjislativ është Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili aprovon ligjet dhe Strategjitë.
Kuvendi ka krijuar Komisionin funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i cili përbëhet nga 11 anëtar nga subjektet e ndryshme politike parlamentare dhe angazhimi i këtij komisioni ka të bëjë me përcaktimin dhe përcjelljen e politikave të zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe mjedisit, i cili monitoron Strategjitë sektoriale për bujqësi dhe mjedis si dhe propozon ligje dhe rekomandime për fushat bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor.
Organi Ekzekutiv më i larte është Qeveria e Kosovës me 17 (shtatëmbëdhjetë ministrit e sajë).
Organ kompetent për mbrojtjen e natyrës në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila nder përgjegjësit e shumta që ka është edhe përkujdesja për ruajtjen e biodiverzitetit dhe menaxhimi me zonat e mbrojtura të natyrës. Ministria zhvillon dhe zbaton politika për ruajtjen dhe administrimin e atyre zonave (Pikat 6 dhe 12 të Shtojcës XI Rregullorja nr. 2002/5.).
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e themeluar me 2002 ka krijuar strukturat brenda sajë – Divizioni për mbrojtjen e Natyrës me sektorët:

- ↳ Sektori për ruajtjen e Biodiverzitetit;
- ↳ Sektori për mbrojtjen e vlerave natyrore të trashëguara;
- ↳ Sektori për mbrojtjen e dheut nga ndotja dhe
- ↳ Sektori për përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Gjatë vitit 2006 me ristrukturim të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) u mbyll Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) pas një periudhe

tridhjetëvjeçare të ekzistimit dhe stafi u ri pozicionua në vendet e ndryshme të punës sipas strukturës organizative të AMMK – së funksionojnë tri drejtori:

- ↳ Sistemi Informativ Mjedisor;
- ↳ Monitorimi i Mjedisit dhe
- ↳ Hartimi i Raporteve dhe Programeve.

Në Ligjin për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233, datë 30.09.2010, në nenin 145 është përcaktuar se punët profesionale për mbrojtjen e natyrës për Republikën e Kosovës i kryen Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sipas dispozitave të këtij Ligji, Instituti është i detyruar të harmonizojë organizimin, veprimtaritë dhe aktet nënligjore me dispozitat e këtij ligji në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
Në drejtorin e Monitorimit të mjedisit janë dy sektor:Monitorimi i mediumeve mjedisore dhe Mbrojtja e natyrës e cila ka tre zyrtar nga një për biodiverzitetin e florës dhe faunës dhe një zyrtar për zonat e mbrojtura.
Mbrojtjen e drejtpërdrejt në zonat e mbrojtura e ushtron Administrata e PN "Mali Sharr" me seli në Prizren dhe ka këtë strukturë organizative:

- ↳ Sektori për planifikim dhe zhvillim;
- ↳ Sektori për marrëdhënie me publikun;
- ↳ Sektori i operimeve dhe
- ↳ Sektori i resurseve njerëzore.

Në kuadër të Inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit vepron inspektori për mbrojtjen e natyrës.
Organizatat Jo Qeveritare janë pjesë e shoqërisë civile dhe përbejnë element të rëndësishëm të bashkëpunimit për çështjet mjedisore. Këto organizata shpesh ofrojnë qasje inovative për zgjidhjen e problemeve të ndryshme mjedisore. Pjesëmarrja e OJQ - ve gjatë hartimit të dokumenteve strategjike, këtyre ja u rrit legjitimitetin. Numri i përgjithshëm i OJQ- ve mjedisore në Kosovë është rreth 70 (shtatëdhjetë).
Nga ky numër janë disa që merren me çështjet e biodiverzitetit. Për tu përmend janë: OJQ "Finch" Prizren, OJQ "ERA" Pejë, OJQ "ECO 99" Prizren, OJQ "Ekologet e Kosovës" Prishtinë, të cilat zhvillojnë aktivitete në ruajtjen e natyrës. Një mbështetje institucionale dhe financiare e këtyre aktiviteteve është zyra vendore e REC – ut me seli në Prishtinë.

6.6.3. Problemet kryesore të identifikuara:

- Menaxhimi i zonave të mbrojtura në nivel të ultë;
- Kompetencat e ngatërruara institucionale në nivelin horizontal dhe vertikal.

6.6.4. Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Të zhvillohen institucione efektive të cilat do të arrijnë rezultate më të mira në ruajtjen e biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore si dhe të funksioalizohet Institui i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- Të institucionalizohet mbledhja, mbajtja dhe përpunimi i shënimeve të mbledhura për biodiverzitetin;
- Të forcohen institucionet për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit ne të gjitha nivelet, posaçërisht shërbimit të inspektimit dhe shërbimit të mbikëqyrjes profesionale dhe
- Të nxitet bashkepunimi me Universitetet dhe kolegjet univerzitare të Kosovës si dhe OJQ-të në projektet hulumtuese: Inventarizimi, Lista e Kuqe etj.

7. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Strategjia përmban një listë të gjatë të zgjidhjeve ose synimeve strategjike të cilat duhet të adresojnë problemet e identifikuara, mundësitë, kërcënimet dhe çështjet. Disa prej këtyre Synimeve Strategjike janë cekur në termet e përgjithshme dhe janë pak a shumë si programe të cilat kërkojnë periudha më të gjata kohore për implementim. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës përkufizon, në mënyrë të qartë, formatin e Planit të Veprimit i cili nevoitet për qëllime praktike të planifikimit dhe financimit, sepse ai identifikon aktivitetet specifike, afatet kohore, institucionin pergjegjes dhe mbeshtetes, burimet e mundshme të financimit dhe rreziqet. Në këtë Strategji Objektivat strategjike jënë dhënë në nënkapitullin 5.2.

Aktivitetet e identifikuara brenda Planit të Veprimt do të zbatohen përmes projekteve specifike, secili aktivitet do të kërkojë një projekt i cili paraqet bazën e aplikacioneve për financim dhe/ose ndarje të burimeve financiare.

Është e qartë që një listë e plotë të Veprimeve do të kërkojë një periudhë të gjatë kohore, ndoshta 10 ose më shumë vite, për implementim. Gjatë procesit të përgatitjes, janë bërë përpjekje për prioritetizimin e listës, duke marrë parasysh çështjet e urgjencës, kërcënimit, mundësisë, financimit dhe mundësisë së suksesit. Janë bërë përpjekje serioze për të zbërthyer programet në veprime specifike brenda programeve. Kjo reflektohet në format të tabelës së Planit të Veprimit.

Është bërë e qartë gjatë procesit të përgatitjes se veprimet e ngjashme strategjike dhe specifike janë identifikuar nga ana e nëngrupeve të ndryshme. Në vend se të listohen këto secilën herë që janë paraqitur brenda seksionit të tyre tematik të Planit, natyra e ndërthurjes së këtyre veprimeve duhet të kihet parasysh në kolonën 1 të tabelës së Planit të Veprimit. Kjo do të thotë që do të nevojitet një qasje bashkëpunuese për implementimin e një plani individual për këto veprime.

Pavarësisht këtyre veprimeve, ka gjasë që pjesë të Planit të Veprimit të implementohen në baza të pjesshme ose provuese. Në disa raste, mësimet e mësuara nga këto pilot programe mund të aplikohen në një bazë më të përgjithshme në veprimet e tjera të ngjashme edhe në pjesë tjera të vendit.

Bashkëpunimi i partnerëve në realizimin e Strategjisë do të jetë vendimtar në suksesin e sajë, mobilizimi i të gjitha kapaciteteve të sektorëve, niveleve të qeverisjes dhe biznesit do të jetë kusht për arritjen e synimeve të këtij dokumenti strategjik.

Roli i komuniteteve lokale, komunitetit të biznesit, OJQ-ve është tejet i rëndësishëm dhe vendimtar në implementimin e masave dhe veprimeve që do të ndikojnë në ruajtjen e biodiverzitetit dhe larmisë peizazhore në vend.

8. ZBATIMI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMI

Institucioni përgjegjes për monitorimin dhe vlerësimin e përmbushjes të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiverzitetin 2011 – 2020 është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Strategjia do të rishikohet pas 10 viteve. Sidoqoftë, Plani i Veprimit duhet të rishqyrtohet pas 5 viteve, deri në cilën kohë situata sociale dhe ekonomike në Kosovë do të ketë ndryshuar. Në atë fazë, do të bëhet një vlerësim i përparimit, duke përdorur të dhënat e mbledhura si pjesë e implementimit të Planit të Veprimit. Kjo nënkupton që monitorimi ndahet në tri faza:

- Rishikimi dhjetëvjeçar i Strategjisë

- ↳ Rishikimi pesëvjeçar i Planit të Veprimit
- ↳ Një rishikim vjetor i implementimit të projekteve.

Ekziston rreziku që vetë monitorimi të shndërrohet në rezultat final. Prandaj ai duhet të mbahet i thjeshtë dhe në gjendje të vlerësojë përparimin përmes përdorimit të indikatorëve përzgjedhës. Si pjesë e fazës së ardhshme të implementimit të Strategjisë, duhet të përgatitet një set i Indikatorëve Nacional të Biodiversitetit, kundrejt të cilëve mund të vlerësohet Strategjia në përgjithësi dhe progresi.
Pasi që Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiverzitetin të jenë aprovuar nga ana e Kuvendit të Kosovës, përgjegjësitë për një program monitorues të Planit të Veprimit duhet t'i jepen MMPH-së. Kjo duhet të ofrojë informacione në baza vjetore tek Kuvendi dhe MMPH-së ku bazohen vendimet mbi veprime ose mungesën e tyre. Ministrive dhe agjencive të tjera ndërlidhëse duhet t'u bëhen të qarta përgjegjësitë dhe linjat e raportimit për zbatimin e këtij plani monitorues dhe përdorimin e tij.
Plani i veprimit ju përmbahet katër kritereve kryesore:

- ↳ Veprimet e planifikuara synim bazë kanë ruajtjen e biodiverzitetit;
- ↳ Aktivitetet identifikohen bazuar në analizën e kërcënimeve për biodiverzitetin;
- ↳ Monitorohen treguesit lidhur me ruajtjen e biodiverzitetit dhe
- ↳ Programet që në mënyrë indirekte ose pjesërisht janë të ndërlidhura me biodiverzitetin përjashtohen nga prioritetet.

Prioritetizimi i regjioneve dhe veprimeve

PILOT ZONAT	GRUPET PUNUESE																	
	INVENTARIZIMI			Shfrytëzimi i tokës					KOMUNIKIMI		SHERBIMET				LIGJORE		PLANIFIKIMI	
	Lloj	Gje	ZM	Buj.	Pyll.	Gju	Pesh	Tur,	Kom	Ed.	ujë	Tran	Ener	Min.	Ligji	Fuqi	P.H.	VNM
1. Bjeshkët e Nemuna	1	1	1	5 4	2 1	1	4	2	2	1	1 2	3 5	5 5	4	2	4	5 4	2
2. Shala e Bajgores	1	1	1	5 3	4 5	4	5	3	1	1	2 4	3 4	1 3	1 3	3	5	4 3	3
3. Anamorava - Vitia	1	1	1	1 *1.1*	5 3	3	1	4	3	3	3 3	2 1	3 2	3 2	4	3	1 3	1
4. Malet e Sharrit	1	1	1	1 5 3	2 2 1	2 2	3 4	1 2	4 4	3 1	4 1 2	3 3 5	5 4 4	5 5 4	1 1	2 1	4 4 2	2 1
5. Drenica	1	1	1	2 2	5 4	5	2	5	1	1	1 5	3 2	1 1	1	5	1	2 3	1

Në njërën nga pesë Punëtorit e organizuara për hartimin e Strategjisë me propozim të ekspertëve të TAIEX-it pjesëmarrësit u pajtuan se duhet të fillohet me projekte të vogla duke pas në konsideratë fondet e pakta në dispozicion. Andaj me një analizë dhe diskutim

të gjithanshëm u përcaktuan pesë pilot zona ku projektet do të mund të rezultonin të suksesshme.
Kjo përzgjedhje është bërë edhe bazuar në kërcënimet për biodiverzitetin dhe larminë peizazhore në zonat e veçanta që kanë bërë operimet nga e kaluara ose edhe ato aktuale.
Nën Grupet Punuese kanë identifikuar pesë pilot zona ku do të fillohet më se paku me nga një projekt.
Pilot zonat:
1. Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare) ku prioritete do të jen: inventarizimi i florës dhe faunës, pylltaria, gjuetia, turizmi, ngritja e vetëdijes dhe ujërat.
2. Shala e Bajgores ku prioritete do të jenë: inventarizimi i florës dhe faunës, zvogëlimi i pasojave nga ish minierat e Trepçës.
3. Anamorava ku prioritete do të jenë: inventarizimi i florës dhe faunës, bujqësia, peshkataria, transporti, planifikimi hapësinor dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis.
4. Malet e Sharrit prioritete do të jenë: inventarizimi i florës dhe faunës, gjuetia, turizmi, fuqizimi i ligjit dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis.
5. Drenica prioritete do të jenë: inventarizimi i florës dhe faunës, peshkimi, komunikimi dhe edukimi, ujërat, energjia, planifikimi hapësinor dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis.
Hartimi i Planit të veprimit për biodiverzitet paraqet një aktivitet kompleks dhe përfshirje të brengave edhe të sektorëve tjerë si shkenca, trashëgimia natyrore, rekreacioni dhe turizmi. Plani i Veprimit për Biodiverzitet do të jetë udhërrëfyes për shpalljen e zonave të mbrojtura të natyrës duke ngritur edhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente për menaxhim me to. Bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm duke pas parasysh se shpallja e zonave të mbrojtura prek shumë interesa dhe njëkohësisht vendos kufizime andaj përcaktimi i saktë i përgjegjësive do të luaj rol të rëndësishëm.

Treguesit

Elementi	**Treguesi**	**Parametri bazë**
Biodiversiteti	Përqindje e territorit e shpallur si e mbrojtur	Sipërfaqja e territorit
Biodiversiteti	Përqindja e llojeve të mbrojtura në rrezik zhdukje	Përqindja e rrezikuar
Legjislacioni	Shkalla e përputhjes midis Legjislacionit Kombëtar dhe Legjislacionit të BE	

Prioritet kryesore për periudhën 2011 – 2020

Bazuar në katër Objektivat Strategjike të kësaj Strategjie kërkohet që të ndërmerren masa dhe veprime për ti evituar kërcënimet për biodiverzitetin duke pas në konsideratë problemet e identifikuara.

Masat kryesore që do të ndërmerren me këtë Plan të Veprimit janë:

Objektivat Strategjike (OS) dhe Masat (M)
OS 1. Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale sipas standardeve të BE-së dhe zbatimi efektiv i sajë.
M. 1. Harmonizimi dhe fuqizimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës me Direktivat dhe Rregulloret e BE – së si dhe nënshkrimi i Konventave kryesore; M. 2. Fuqizimi dhe institucionalizimi i organeve kompetente për zbatimin e masave dhe veprimeve për ruajtjen e biodiverzitetit;
OS 2. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative në baraspeshë natyrore.
M. 1. Shtimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura të natyrës në 10% të territorit të Republikes së Kosovës dhe menaxhimi efektiv i tyre; M. 2. Hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe vendbanimeve natyrore; M. 3. Mbrojta Ex - situ e resurseve gjenetike bimore dhe shtazore M. 4. Punet përgatitore për themelimin e "Natura 2000"
OS 3. Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshem i biodiverzitetit dhe ndarja e barabartë e përfitimeve.
M.1. Promovimi i vlerës ekonomike të biodiverzitetit dhe ruajtja e biodiverzitetit të bëhet pjesë e politikave të sektorëve tjerë përmes zbatimit të Vlerësimit të Pranueshmerisë së Nderhyrjes në Natyrë dhe Mjedis; M. 2. Nxjerrja i Planeve Hapësinore dhe planeve për menaxhim të zonave të mbrojtura të natyrës; M. 3. Ngritja e vetëdijës dhe bashkepunimit tek të gjithë sektoret për biodiverzitetin
OS 4. Promovimi i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiverzitetin.
M. 1. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve për ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e natyrës, biodiversitetit dhe peizazheve si dhe vlerave të tyre ekonomike dhe financiare; M. 2. Fuqizimi i shkencave taksonomike dhe zbatimi i programeve në Universitetit për hartat, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit

VEPRIMET - PROJEKTET PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR BIODIVERZITETIN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2011 – 2015

Veprimet - Projektet e rekomanduara në këtë Strategji dhe Plan të Veprimit janë një listë e gjerë e të gjitha politikave, legjislacionit, planeve dhe programeve që janë të nevojshme për përmirësim në sektorë të ndryshëm të vendit. Kjo Strategji potencon rëndësinë e pjesëmarrjes së njerëzve dhe bashkë-menaxhimin e të gjitha aspekteve të ruajtjes së biodiversitetit duke ditur faktin se kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit janë aktivitetet e njeriut.

Aktivitetet e planifikuara me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiverzitet do të formulohen përmes projekteve të veçanta për zbatim. Koordinimi i përgjithshëm do të jetë përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Zbatimi do të bëhet përmes një procesi gjithëpërfshirës për arritjen e synimeve të dëshiruara.

Objektiva/Masa		**Veprimet - Projektet**	**Përgjegjësia për zbatim**	**Buxheti €**	**Afati / periudha e zbatimit**
OS1	M1	i. Nxjerrja e akteve nënligjore që dalin nga Ligji për mbrojtjen e natyrës	MMPH/ Qeveria	50.000	2011 - 2012
		ii. Promovimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës tek komuniteti	MMPH	Buxheti i rregullltë [1]	2011 - 2015
		iii. Nxjerrja e programeve për mbrojtjen e natyrës nga të gjitha komunat	Komunat	180.000	2011- 2015
		iv. Ratifikimi i Konventave për Biodiversitetin, Bonit, Bernit, Parizit, CITES, dhe Traktateve tjera relevante	MMPH/ Kuvendi	Buxheti i rregullltë	2011 - 2015
		v. Harmonizimi, fuqizimi i legjislacionit dhe sqarimi i kompetencave për menaxhimin e Parqeve Kombëtare	MMPH/ MBPZhR	Buxheti i rregullltë	2011
		vi. Fuqizimi dhe institucionalizimi i organeve kompetente për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiverziteti	MMPH	250.000	2011 - 2015
		vii. Themelimi i organeve menaxhuese për të gjitha zonat e mbrojtura të natyrës	MMPH/ MBPZhR, Komunat	400.000	2012 - 2015
	M2	i. Krijimi i Eko fondit	MMPH/ MeF Kuvendi	Buxheti i rregullltë	2011

[1] Linja bugjetore e MMPH – paga, mallëra dhe sherbime

Objektiva/ Masa		Veprimet - Projektet	Përgjegj - ësia për zbatim	Buxheti €	Afati / periudha e zbatimit
OS2	M1	i. Shpallja e Bjeshkëve të Nemuna Park Kombëtar dhe themilimi i Drejtorisë për administrim	MMPH, Kuvendi	500.000	2011 - 2015
		ii. Analizë e zbraztirave të sistemit të zonave të mbrojtura në kuptim të mbulueshmerisë së llojeve dhe vendbanimeve natyrore reprezentative	MMPH	50.000	2015
		iii. Shpallja e Zonave të Rëndësishme të Zogjve	MMPH	100.000	2011 - 2012
	M2	i. Krijimi i Sistemit Qendror Informativ për biodiverzitetin	MMPH	Buxheti i rregullltë	2011 - 2012
		ii. Ndertimi i kapaciteteve njerzore dhe teknike për identifikimin e llojeve dhe vendbanimeve natyrore si dhe për hartat	MMPH	150.000	2011 - 2013
		iii. Inventarizimi i llojeve bimore dhe shtazore të Kosovës	MMPH	250.000	2012 - 2014
		iv. Inventarizimi dhe paraqitja hartografike e llojeve të rralla të florës dhe faunës në Bjeshkët e Nemuna	MMPH	130.000	2012 - 2013
		v. Inventarizimi dhe paraqitja hartografike e llojeve të rralla të florës dhe faunës së Malit Sharr	MMPH	130.000	2013 - 2014
		vi. Inventarizimi i zogjve në Malet e Sharrit	MMPH/ OJQ	200.000	2014 - 2015
		vii. Inventarizimi i llojeve invazive të bimëve	MMPH/ MBPZhR	10.000	2012
		viii. Inventarizimi i zogjve në Bjeshkët e Nemuna	MMPH/ OJQ	200.000	2013 - 2014
		ix. Zhvillimi i manualit pasqyrë për interpretimin e biotopeve dhe llojeve të vendbanimeve	MMPH	100.000	2013
		x. Zhvillimi i inventarit dhe hartave të shtrirjes së biotopeve dhe llojeve të vendbanimeve	MMPH	212.000	2012 - 2014
	M3	i. Fuqizimi i Bankës së Resurseve Gjenetike bimore	UP	-	2012 - 2015
		ii. Themelimi i Bankës së Resurseve Gjenetike shtazore	UP	-	2013 - 2015
	M4	i. Zhvillimi i një plan pune për përzgjedhjen e zonave Natura 2000 me tregues për të dhënat e nevojshme, përgjegjësitë, afatet kohore dhe buxhetin.	MMPH	Buxheti i rregullltë	2015
		ii. Mbledhja e të dhënave për tipat e vendbanimeve natyrore me prioritet dhe llojeve sipas Direktivës së vendbanimeve, sipërfaqet e përgjithshme të llojeve të vendbanimeve dhe numrat e popullacionit të llojeve për Kosovën	MMPH	Buxheti i rregullltë	2014
		iii. Prodhimi i hartave të shpërndarjes për të gjitha llojet e vendbanimeve dhe llojet e pranishme në Kosovë në bazë të të dhënave ekzistuese	MMPH	Buxheti i rregullltë	2014
		iv. Sigurimi i pajisjeve për hulumtim dhe monitorim të resurseve natyrore	MMPH	10.000	2011
		v. Nxjerrja e Listës së Kuqe – Libri i Kuq	MMPH	61.000	2013 - 2014

Objektiva/ Masa		Veprimet - Projektet	Përgjegj - ësia për zbatim	Buxheti €	Afati / periudha e zbatimit
OS3	M1	i. Zbatimi i procedurave mjedisore VSM, VNM	MMPH Operatoret	Buxheti i rregullt ë	2011 - 2015
		ii. Futja e kushteve për mbrojtjen e natyrës tek sektorët tjerë gjat nxjerrjes së Strategjive, ligjeve, programeve dhe planeve	MMPH/ MEM/MT I/MTPT/ MBPZhR	Buxheti i rregullt ë	2011 - 2015
	M2	i. Nxjerrja e Planit Menaxhues të PK "Mali Sharr"	MMPH	1.000.000	2012 - 2013
		ii. Nxjerrja e Planeve menaxhuese për zonat tjera të mbrojtura të natyrës (mbi 500 ha) dhe gjitarët e mëdhenj	MMPH MBPZhR	1.000.000	2014 - 2015
		iii. Krijimi i Keshillit kombetar në kuadër të MMPH me pjesemarrjen e të gjitha ministrive dhe institucioneve relevante që do të diskutojn për zbatimin e SPVB	MMPH	Buxheti i rregullt ë	2012 - 2015
	M3	i. Zhvillimi i masave shtytëse për promovimin e ruajtjes së biodiverzitetit tek sektoret tjerë	MMPH/ MEM/MT I /MTPT/M BPZhR	Buxheti i rregullt ë	2012 - 2015
		ii. Shqyrtimi i politikave dhe legjislacionit tek sektorët tjerë lidhur me objektivat, praktikat dhe rregulloret me ndikim negativ potencial në biodiverzitet	MMPH/ MEM/MT I/MTPT/ MBPZhR	Buxheti i rregullt ë	2012 - 2015

Objektiva/ Masa		Veprimet - Projektet	Përgjegj - ësia për zbatim	Buxheti €	Afati / periudha e zbatimit
